

BASHKIA
KESHILLI BASHKIAK

RREGULLORE
PER NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE NDERVEPRIMIN E
STRUKTURAVE KOMUNITARE NE BASHKI

(model)

Mirënjohje

Ky model rregullore u hartua në kuadër të projektit Bashki të Forta, i zbatuar nga Helvetas dhe i financuar nga Qeveria Zvicerane.

Autorët:

Ky dokument u hartua nga
Artan Rroji, MA

Kontribuan:

Fatlum Nurja
tjetër _____

Mirënjohje:

Versioni i fundit i kesaj rregullore gjendet në farqe e internetit të Bashkisë, apo mund të merret e fotokopjuar nga Sekretariati i Këshillit.

Historiku i rregullores më të fundit

Versioni i bërë publik	Formati (Word, Pdf)	Datë	Ndryshimi
Projekt rregullorja për konsultim publik	Word	____.01.2020	
Versioni 1.0	Word	____.02.2021	Përfshirë komentet e publikut_projekt
Versioni 1.1	Pdf	____.03.2020	Rregullorja e miratuar
Versioni 1.2	Pdf	____.10.2020	Ndryshimi: (p.sh, neni 5, ndyshon në ...)

Parathënje

E drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike vendore bën pjesë në parimet e përbashkëta të shtetet demokratike, dhe ushtrimi i kësaj të drejte në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë rrit dhe fuqizon demokracinë vendore dhe garanton një vendimarrje sa më afër interesave, nevojave dhe pritshmërive të qytetarëve.

Demokracia vendore pasurohet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesit në qeverisjen vendore dhe më së pari mundësohet nga qeverisja e mirë vendore. Hartimi i politikave vendore që synojnë avancimin e cilësisë së jetës të komuniteteve, ushtrimin e të drejtave të tyre civile dhe politike, dhe që garantojnë përdorimin sa më efektiv dhe eficient të burimeve vendore nga bashkitë, kërkon një pjesëmarrje aktive të komunitetit dhe grupeve të interesit në qeverisjen vendore, dhe një qeverisje sa më afër qytetarëve.

Bashkitë e Shqipërisë duhet të garantojnë ushtrimin e të drejtave të qytetarëve për pjesëmarrje në qeverisjen vendore. Ato kanë në misionin e tyre nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore,¹ detyrimin të garantojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimarrjes², të marrin në shqyrtim kërkesat e qytetarëve dhe t'u kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj³, si dhe detyrimin të pranojnë dhe të shqyrtojnë iniciativat qytetare për vendimarrje bashkiake.⁴

Bashkitë përfitojnë shumë nëse komunitetet vendore dhe shoqëria civile janë dinamike dhe pjesëmarrëse, dhe për këtë arsye ato duhet t'i ndërgjegjësojnë dhe inkurajojnë ata, të lehtësojnë qasjen e tyre në informacion dhe legjislacion cilësor, t'i fuqizojnë ato duke shtuar njohuritë, aftësitë dhe ngritur kapacitetet e tyre, në mënyrë që bashkitë dhe komunitetet të ndërtojnë sëbashku një system të qëndrueshëm pjesëmarrjeje.

Por ndërkohë shqetësimet kryesore në bashkitë e Shqipërisë mbeten interesimi dhe angazhimi i ulët i qytetarëve në proceseve politike dhe qeverisëse vendore, si dhe mungesa e akteve rregullative të bashkive për të udhëzuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve.

Këshilli Bashkiak dëshiron të promovojë forma të reja të angazhimit qytetare dhe të ndërveprimi midis bashkisë dhe qytetarëve dhe grupeve të interesit duke patur besimin se menaxhimi komunitar nuk zëvendëson menaxhimin publik, por fuqizon menaxhimin dhe politikat publike bashkiake.

Strukturat komunitare përbëjnë mekanizma aktivë dhe eficientë që promovojnë, nxisin, dhe mbështesin pjesëmarrjen dhe angazhimin e komunitetit dhe grupeve të interesit në politikëbërjen dhe vendimarrjen e bashkisë. Ato kultivojnë sensin e jetës komunitare dhe bashkëpunimin midis komunitetit dhe OJF-ve, kultivojnë kulturën e bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes me bashkinë, nxisin dhe mbështesin përfshirjen e grupeve vulnerabël në procesin e politikëbërjes dhe vendimarrjes së bashkisë.

Ngritja, fuqizimi dhe funksionimi efektiv i strukturave komunitare është një sfidë për bashkinë dhe komunitetet. Ndërkohë bashkia angazhohet të hartojë politika dhe rregullore, të ngrejë mekanizma dhe të alokojë fonde në mënyrë që strukturat komunitare të jëtesohen dhe fuqizohen në vazhdimësi.

Kjo rregullore ka si qëllim pikërisht të sjellë risi në adresimin e sfidave të pjesëmarrjes, të prezantojë mekanizma dhe të përcaktojë rregulla, përgjegjësi dhe procedura për t'i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit një pjesëmarrje aktive në proceset politikëbërëse dhe vendimarrëse nëpërmjet strukturave komunitare.

Kjo rregullore do të kontribuojë gjithashtu në ndryshimin e sjelles dhe të praktikave të punës së bashkive dhe në ridimensionimin e ndërveprimit të tyre me komunitetin.

¹ Ligji nr. 139/2015, neni 3/dh.

² Ligji nr. 139/2015, neni 16/1.

³ Ligji nr. 139/2015, neni 19/2.

⁴ Ligji nr. 139/2015, neni 20/1.

Tabela e përmbajtjes	
Parathënje	3
KAPITULLI I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME	7
KREU I. QELLIMI, OBJEKTI, BAZA LIGJORE E RREGULLORES	7
Qëllimi i rregullores.....	7
Objekti i rregullores	7
Baza ligjore.....	7
Përkufizimet dhe shkurtimet.....	8
KAPITULLI II. POLITIKA BASHKIAKE, ORGANET E STRUKTURAVE KOMUNITARE 10	
KREU I. POLITIKAT DHE INSTRUMENTET BASHKIAKE	10
Politika e bashkisë për strukturat komunitare	10
Politika e shtrirjes territoriale të strukturave komunitare.....	11
Njësia për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve	11
Fondi i fuqizimit të komuniteteve.....	12
KREU II. STRUKTURAVE KOMUNITARE DHE PALËT E INTERESUARA	13
Misioni i strukturave komunitare.....	13
Statusi i strukturave komunitare	13
Palët e interesuara të strukturave komunitare	14
Mandati i kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar.....	14
Autoriteti i kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar.....	14
Roli i kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar	15
KREU III. ORGANET E STRUKTURAVE KOMUNITARE	16
Anëtarësia e kryesisë dhe e këshillit komunitar	16
Kufizimet e mandatit të anëtarit të kryesisë apo këshillit	16
Mungesat në detyrë e anëtarit të kryesisë apo këshillit.....	17
Përfundimi i mandatit të anëtarit të Kryesisë apo Këshillit	18
Vendet e lira në kryesi dhe këshill	19
Komisionet e kryesive apo këshillave.....	20
Mbrojtja ndaj përgjegjësive publike	20
Kufizimet e veprimeve të organeve të strukturave komunitare	20
Financat dhe buxheti i strukturës komunitare	21
Trajnimi i anëtarëve të kryesive apo këshillave.....	22
KREU IV. PËRGJEGJËSITË E KRYESISË APO KËSHILLIT KOMUNITAR	22
Përgjegjësitetë e kryesisë apo këshillit	22
Detyrat e kryetarit të fshatit apo ndërmjetësit	23
KAPITULLI III. INICIATIVA PER NGRITJEN E KËSHILLIT KOMUNITAR	26
KREU I. TERRITORI DHE ANËTARËSA E KËSHILLIT KOMUNITAR	26
Paraqitja e iniciativës	26
Territori i këshillit komunitar	26
Numri i anëtarëve të këshillit komunitar	26
KREU II. CERTIFIKIMI I INICIATIVËS PËR NGRITJEN E KËSHILLIT KOMUNITAR 27	
Qëllimi i certifikimit	27
Kërkesat për certifikim	27
Parashtuesit e aplikimit.....	28

Bordi i certifikimit	29
Procesi i certifikimit	30
Seancat dëgjimore për certifikimit e iniciativës	31
Shqyrtimi i aplikimit për certifikim	32
Anullimi i certifikatës së Këshillit	33
KAPITULLI IV. ZGJEDHJET E ORGANEVE TE STRUKTURAVE KOMUNITARE	34
KREU I. PËRGATITJA, ADMINISTRIMI, MBIKQYRJA E ZGJEDHJEVE	34
Komisioni për administrimin e zgjedhjeve	34
Komisioni qendror për monitorimin e zgjedhjeve	34
Komisioni i qendrës së votimit	35
Përgatitja se zgjedhjeve të kryesisë apo këshillit	35
Përzgjedhja e qendrave të votimit	36
Orari i votimit	36
KREU II. KANDIDATET PËR ANËTARË TË KRYESISË APO KËSHILLIT	37
Kriteret e kandidatit	37
Kufizimet për kandidim	37
Dokumenet e aplikimit që duhet të paraqesë kandidati	38
Formulari i kandidatit për anëtar të këshillit komunitar	38
Certifikimi i kandidatëve për kryesinë apo këshillin	39
Kundërshtimi i kandidatit	39
Fushata zgjedhore e kandidatëve të certifikuar	40
KREU III. ZGJEDHJA E ANETAREVE TE KRYESISË SË FSHATIT	40
Mbajtja dhe vlefshmëria e zgjedhjeve të kryesive të fshatrave	40
Votimi për Kryesinë	41
Mbyllja e votimit	41
Vlerësimi i votave, nxjerrja e rezultatit dhe shpallja e fituesve	41
Dokumentimi i procesit të votimit	42
Ankesat për Procesin e Votimit	42
KREU IV. ZGJEDHJA E ANETAREVE TE KËSHILLAVE KOMUNITARE	43
Votuesit për zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Komunitar	43
Mbajtja e zgjedhjeve	43
Fleta e votimi	44
Votimi për Këshillin	44
Vlerësimi i votave, nxjerrja e rezultatit dhe shpallja e fituesve	45
Dokumentimi i procesit të votimit dhe administrimi i materialeve zgjedhore	45
KREU V. ZGJEDHJA E DREJTUESVE TE STRUKTURAVE KOMUNITARE	45
Mbledhja e parë e këshillit apo kryesisë	45
Zgjedhja e kryetarit të fshatit dhe ndërlidhësit komunitar	46
KAPITULLI IV. FUNKSIONIMI DHE NDERVEPRIMI I KRYESISË DHE KËSHILLIT	47
KREU I. MBLEDHJET E KRYESISË DHE KËSHILLIT	47
Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së kryesisë dhe këshillit	47
Rendi i ditës i mbledhjes	47
Mbajtja e mbledhjes	48
Kuorumi	48
Procesverbali i mbledhjes	49
Votimi në mbledhje	49

Pezullimi i përkohshëm nga mbledhja i anëtarit	49
Rishqyrtimi i vendimit të kryesisë dhe këshillit.....	50
Përgjegjësitë dhe detyrat e kryesuesit të mbledhjes së Kryesisë apo Këshillit	50
Shqyrtimi i ankesave.....	50
KREU II. MARRËDHËNIET E KRYESIVE DHE KËSHILLAVE ME BASHKINE	51
Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak.....	51
Marrëdhëniet me Kryetarin e Bashkisë.....	51
Marrëdhëniet me drejtoritë apo sektorët e Bashkisë	51
Marrëdhëniet me administratorin e NjA	52
Marrëdhëniet me Policinë Bashkiake	52
Veprimet e ndërlidhësit apo kryetarit të fshatit në lidhje sigurinë publike	53
KREU III. KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI I KOMUNITETIT.....	53
Komunikimi me komunitetin.....	53
E drejta e informimit dhe transparenca	54
Mobilizimi dhe angazhimi i komunitetit.....	54
KREU IV. VLERESIMI DHE LLOGARIDHENJA E STRUKTURAVE KOMUNITARE	55
Etika në punën e strukturave komunitare.....	55
Mbikqyrja dhe vlerësimi i Strukturave Komunitare	55
Vetëvlerësimi dhe llogaridhënja e strukturave komunitare	55
KREU V. MJETEVE DHE DOKUMENTEVET E KRYESISE DHE KESHILLIT	56
Vula dhe stema e strukturave komunitare.....	56
Administrimi dhe ruajtja e dokumentacionit të Kryesisë apo Këshillit	56
KREU VI. FORUMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE.....	57
Forumi i Ndërlidhësve Komunitarë dhe Krytarëve të Fshatrave	57
Rregullorja e strukturës komunitare	57
Përdorimi i rregullores së këshillit bashkiak.....	58
Konsultimi publik i rregullores.....	58
KREU VII. DISPOZITA KALIMTARE	58
Shtojcat	59
Shtojca nr. 1 Format aplikimi për certifikimit të iniciativës qytetare për ngritjen e strukturës komunitare.....	59
Shtojca nr. 2: Model deklaratatë e angazhimit civil të kandidatit për anëtar të kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar.	60
Shtojca nr. 3: Model strukturë e rregullore së kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar.....	61
Referencat.....	63

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PERGJITHSHME

KREU I

QELLIMI, OBJEKTI, BAZA LIGJORE E RREGULLORES

Neni 1

Qëllimi i rregullores

1. Të sigurojë një sistem dhe proces të drejtë, të qartë, të njësuar, funksional dhe gjithëpërfshirës për ngritjen dhe funksionimin e strukturave komunitare në nivel fshati dhe lagjeje.
2. Të përcaktojë standartet që i mundësojnë strukturave komunitare të veprojnë në mënyrë transparente, përfshirëse, bashkëpunuese, të hapur dhe llogaridhënëse në raport me komunitetet që përfaqësojnë.

Neni 2

Objekti i rregullores

Kjo rregullore ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për ngritjen, organizimin, funksionimin e strukturave komunitare në nivel fshati dhe lagjeje, përcaktimin e funksioneve, përgjegjësisë dhe detyrave të organeve të tyre, si dhe përcaktimin e mënyrave dhe formave të ndërveprimit të këtyre strukturave me bashkinë dhe komunitetin.

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore kryesore ku është mbështetur hartimi i kësaj rregulloreje është:

1. Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 8548 datë 11.11.1999 “Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”.
3. Ligji nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
5. Ligji nr. 44 datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.
6. Ligji nr. 8480 date 27.5.1999, “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.
7. Ligji nr. 115 datë 31.7.2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.
8. Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”.
9. Ligji nr. 146 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
10. Ligji nr. 68 datë 27.04. 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.
11. Ligji nr. 152 datë 17.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”.
12. Ligji nr. 107 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

13. Ligji nr. 45 datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
14. Ligji nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.
15. Ligji nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
16. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”, i ndryshuar
17. Ligjinr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”
18. Ligji nr. 10 296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
19. Ligji nr. 138 datë 17.12. 2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike”.
20. Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale“, i ndryshuar.
21. Ligji nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i përditësuar.

Neni 4

Përkufizimet dhe shkurtime

1. Në këtë rregullore, termat kanë kuptimin sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Termat që i referohen anëtarëve dhe drejtuesvë të Strukturave Komunitare duhen kuptuar e interpretuar si terma që përfshijnë të dyja gjinitë.
3. Në çdo rast përdorimi a interpretimi, do të merren përkufizimet e dhëna në Shtojcën nr. 1, të Rregullores së Këshillit Bashkiak.

Bashkia: Qeveria bashkiake në të dyja format e saj, vendimmarrëse dhe ekzekutive.

Banor: person që banon në territorin e fshatit apo lagjes, pavarësisht nëse është i regjistruar apo jo në zyrën e gjendjes civile të bashkisë që ka në juridiksion territorial vendbanimin e tij apo banesën e deklaruar.

Certifikimi i iniciativës për ngritjen e strukturës komunitare në lagjen e qytetit: Njohja zyrtare nga këshilli bashkiak i territorit dhe autorizimi nga ana e tij e ngritjes së strukturës komunitare në një lagje, në një pjesë të saj, apo në territorin e më shumë se një lagjeje.

Grup interesi për komunitetin: është organizatë apo një grup organizatash jofitimprurëse, përfshirë ato arsimore e fetare, që përfaqësojnë interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë në komunitet, apo një grup me bazë komunitare, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara⁵ për politikën, aktet apo vendimmarrjen e këshillit bashkiak që i ndikojnë komunitetit dhe territorit të bashkisë, lagjes apo fshatit. Organizatat duhet të kenë një adresë sëpaku për një periudhë një (1) vjeçare brenda kufijve të Bashkisë dhe duhet të ushtrojnë aktivitet të verifikueshëm dhe me përfitime direkte për komunitetin apo territorin e bashkisë, lagjes apo fshatit.

Fshat: territor kryesisht rural, me emërtim dhe kufi të përcaktuar me ligj.

Kryetar i Fshatit: personi i zgjedhur nga anëtarët e Kryesisë së Fshatit që drejton dhe organizon punën e Kryesisë, dhe mban lidhjet e Kryesisë me Bashkinë, dhe përfaqëson Kryesinë në marrëdhëniet me aktorët e tjerë.

⁵ Ligji nr. 146/2014, neni 2.

Këshill Komunitar: strukturë komunitare vendore, e cila ngrihet në nivel lagje, disa zona të lagjes apo në më shumë se një lagje, në bazë të iniciativës qytetare, dhe përbëhet nga banorë të lagjes.⁶

Kryesia e Fshatit: strukturë komunitare vendore, e cila ngrihet në nivel fshati, këshillon Kryetarin e Fshatit, dhe përbëhet nga banorë të fshatit.⁷

Kryesia apo Këshilli: Kryesia e Fshatit apo Këshilli Komunitar i Lagjes.

Kryetari apo Ndërlidhësi: Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi Komunitar.

Komisioni i Përhershëm për Strukturat Komunitare: Komisionit të Përhershëm i Këshillit Bashkiak për Mandatet, Rregulloren, Zgjedhjet, Strukturat Komunitare dhe Peticionet.

Lagje: lagje e qytetit, me territor kryesisht urban, emri dhe kufijtë e të cilës përcaktohen nga Këshilli Bashkiak.

Mobilizim komunitar: procesi i ndërlidhjes së sektorëve të ndryshëm të komunitetit dhe krijimi i partneriteteve me qëllim trajtimin e çështjeve që shqetësojnë komunitetin. Mobilizimi komunitar përfshin aktivizimin e burimeve, shpërndarjen e informacionit, sigurimin e mbështetjes dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publik dhe atyre privat në komunitet.⁸

Ndërlidhës komunitar: personi i zgjedhur nga anëtarët e Këshillit Komunitar që drejton dhe organizon punën e Këshillit⁹, dhe mban lidhjet e Këshillit Komunitar me Bashkinë, si edhe përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me aktorët e tjerë.

Ndërmjetësim: një proces konfidencial dhe joformal i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, nëpërmjet të cilin një person i paanshëm, ndërmjetësi, lehtëson komunikimin ndërmjet palëve në konflikt me qëllimin për të mundësuar zgjidhjen e konfliktit, pajtimin ose mirëkuptimin mes palëve në konflikt.

NjA: Njësia Administrative e Bashkisë.

Njësia për komunitetet: Njësia për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve pranë Bashkisë.

Politikë publike: një sistem ligjesh, rregullash dhe strategjish, si dhe drejtime apo mënyra veprimi në lidhje me një temë të caktuar, e shpallur nga Këshilli Bashkiak, dhe që ka për qëllim të udhëzojë dhe përcaktojë vendimet e tanishme dhe të ardhshme të Bashkisë.

Sekretari i Këshillit: Sekretari i Këshillit Bashkiak.

Strukturë Komunitare: bashkësia e banorëve, e pronarëve të banesave dhe të bizneseve që ndodhen brenda territorit të lagjes apo fshatit, të organizuar në mënyrë vullnetare dhe që bashkëpunojnë për zhvillimin e komunitetit dhe territorit, fuqizimin e komunitetit dhe të pjesëmarrjes së tij në politikëbërjen dhe vendimmarrjen bashkiake dhe komunitare, dhe që është e autorizuar nga bashkia të përfaqësojë komunitetin e një territorit të caktuar.

⁶ Ligji nr. 139/2015, neni 68.

⁷ Ligji nr. 139/2015, neni 70.

⁸ IDM, Strukturat Komunitare në Shqipëri, Manual, 2016 (Advocates for Youth, 2014).

⁹ Ligji nr. 139/2015, neni 68/3.

KAPITULLI II
KORNIZA E POLITIKES BASHKIAKE DHE ORGANET
E STRUKTURAVE KOMUNITARE

KREU I

POLITIKAT DHE INSTRUMENTET BASHKIAKE

Neni 5

Politika e bashkisë për strukturat komunitare

1. Të promovojë dhe të nxisë në mënyrë aktive formimin e strukturave komunitare në të gjithë territorin e bashkisë.
2. Të respektojë diversitetin, dinjitetin dhe shprehjen e pikëpamjeve nga të gjithë individët, grupet dhe organizatave brenda territorit të bashkisë.
3. Të inkurajojë, nxisë dhe mbështesë strukturat komunitare dhe të gjithë palët e interesuara të komunitetit të marrin pjesë në aktivitetet dhe procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së bashkisë, dhe bashkëprodhimin e politikave publike në dobi të komuniteteve.
4. Të mbajë qëndrim jopartiak në raport me përkatësinë politike të banorëve, dhe të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë, procesin e zgjedhjes së kryesive të fshatrave dhe këshillave komunitarë, si dhe mbështetjen e veprimtarisë së tyre.
5. Të ngrejë dhe përdorë një sistemin e njoftimit të hershëm për të informuar strukturat komunitare dhe palët e interesuara të komunitetit për hartimin e politikave, normave, standarteve, e për çështje që përfshijnë dhe shqetësojnë bashkinë dhe komunitetin, në mënyrë që t'u sigurojë të gjitha palëve mundësinë të përfshihen sa më herët në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së bashkisë.
6. Të ofrojë ngritje kapacitetesh në vazhdimësi për fuqizimin e strukturave komunitare, me qëllim realizimin e misionit të tyre, rritjen e efektivitetit të kontributit të tyre në formësimin e politikave bashkiake, si dhe rritjen e angazhimit qytetar dhe të ndërveprimit komunitar në lagje apo fshat.
7. Të mundësojë procedura të drejta, të hapura dhe transparente për gjithë veprimtarinë e bashkisë në lidhje me mbështetjen e strukturave komunitare.
8. Të vërë në dispozicion të strukturave komunitare fonde për të nxitur dhe mbështetur zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve të propozuara prej tyre.
9. Të eliminojë diskriminimin në bazë të racës, fesë, origjinës kombëtare, seksit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar, statusit martesor, të ardhurave, statusit të pronarit të shtëpisëapoqiramarrësit, ose përkatësisë politike, ndaj çdo individi ose grupi interesi, përgjatë ushtrimit të funksioneve, përgjegjësisë dhe veprimtarive të bashkisë në lidhje me strukturat komunitare.

Neni 6

Politika e shtrirjes territoriale të strukturave komunitare

1. Juridiksioni i autoritetit të strukturave komunitare përputhet me shtrirjen territoriale të strukturave komunitare në nivel fshati apo lagje.
2. Shtrirja territoriale dhe emri i fshatrave përcaktohen me ligj¹⁰. Bashkia _____ ka _____ fshatra: 1. Fshati ____ (sip. _____), 2. _____ (sip. _____), 3. ____ (sip. _____), etj.
3. Numri i lagjeve dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.¹¹ Bashkia _____ ka _____ lagje: 1. Lagjia ____ (sip. _____), 2. _____ (sip. _____), etj.
4. Bashkia vë në dispozicion të komunitetit dhe të organeve drejtuese të strukturave komunitare kopje të hartave territoriale të fshatrave dhe lagjeve.
5. Ndarja e lagjeve dhe e fshatrave bazohet në politikën e kohezionit social dhe territorial.
6. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve¹², vendim i cili merret vetëm pas konsultimit me komunitetin e lagjeve të përfshira.
7. Një këshill komunitar mund t'i kërkojë këshillit bashkiak të marrë vendim për ndryshimin e kufijve të strukturës komunitare bazuar në rritjen ose uljen numrit të popullsisë, apo me qëllimin për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e punës së këshillit komunitar.

Neni 7

Njësia për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve

1. Bashkia krijon, bën funksionale dhe fuqizon njësinë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve (në vazhdim “Njësia”).
2. Njësia zbaton detyrat kryesore si më poshtë:
 - a. Harton projekt politika dhe projekt udhëzime për mirë funksionimin e strukturave komunitare.
 - b. Promovon dhe lehtëson komunikimin, koordinimin dhe bashkërendimin e punëve mes bashkisë dhe strukturave komunitare.
 - c. Udhëzon dhe këshillon strukturat komunitare për të ushtruar përgjegjësite dhe zbatuar detyrat e tyre në mënyrë të ligjshme, efiçente, efektive dhe transparente, si dhe i ndihmon këta të fundit për mënyrën e dhënjes së komenteve dhe propozimeve për Këshillin Bashkiak dhe Kryetarin e Bashkisë.
 - d. Ndjek zbatimin dhe mbikëqyr pajtueshmërinë e funksionimit e strukturave komunitare me këtë rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.
 - e. **Zbaton projekte dhe programe për promovimin dhe nxitjen e formimit të strukturave komunitare në të gjithë territorin e bashkisë.**
 - f. Siguron mbështetje operationale dhe lehtëson vënien në dispozicion të strukturave komunitare, të burimeve, mjeteve dhe mjediseve për zyra, pajisjeve dhe mjeteve të komunikimit.

¹⁰ Ligji nr. 139/2015, nenei 6/2.

¹¹ Ligji nr. 139/2015, nenei 6/3.

¹² Idem

- g. Promovon dhe koordinon aktivitetet, si dhe organizon trajnimet për rritjen e njohurive dhe të kapaciteteve të strukturave komunitare.
- h. Ndhmon strukturat komunitare në procesin e zgjedhjes së organeve drejtuese të tyre.
- i. Ndhmon kandidatët për anëtarë të organeve drejtuese të strukturave komunitare për të përgatitur dokumentacionet për kandidim.
- j. Promovon dhe koordinon takimeve dhe lehtëson komunikimin ndërmjet strukturave komunitare.
- k. Propozon, ndërton dhe mirëmban sistemin të njoftimit të hershëm në ndihmë të strukturave komunitare, për të gjitha vendimmarrjet e bashkisë.
- l. Informon publikun për procesin e certifikimit të këshillave komunitarë.**
- m. Ndhmon në organizimin dhe mbajtjen e forumit të strukturave komunitare.
- n. Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave për strukturat komunitare, duke përfshirë, emrat dhe informacionin e kontaktit për anëtarët dhe drejtuesit e strukturave komunitare, që do të jenë në hapura për publikun.
- o. Mban të dhënat e fondeve të transferuar strukturave komunitare nga bashkia dhe aktorë, mban një kopje elektronike të vendimeve të marra nga strukturat komunitare, si dhe mban listën vjetore të projekteve të zbatuara apo në proces zbatimi nga strukturat komunitare.
- p. Harton projekt listën e treguesve të performancës për vlerësimin e performance së strukturave komunitare dhe ia paraqet këshilli bashkiak për miratim.
- q. Bën vlerësimin vjetor të performancën së veprimtarisë së strukturave komunitare të bashkisë dhe e bën atë pjesë të raportit vjetor për strukturat komunitare.
- r. Raporton çdo katër muaj, tek komisioni i përhershëm përkatës i këshillit bashkiak për veprimtarinë e strukturave komunitare.
- s. Mban dhe përditëson të dhënat dhe informacionet për kandidatët dhe zgjedhjet për Kryesitë dhe Këshillat, dhe i publikon ato në faqen e internetit të bashkisë.
- t. **Brenda vitit të dytë të mandatit të Këshillit Bashkiak, ndërmerr një anketim me banorët dhe grupet e interesuara për të indentifikuar problemet e hasura gjatë procesit zgjedhor të strukturave komune, dhe harton raportin përkatës të cilin ia paraqet Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë.**

Neni 8

Fondi i fuqizimit të komuniteteve

1. Bashkia vë në dispozicion të strukturave komunitare pjesë të fondit për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve (në vazhdim “Fondi”), me qëllim fuqizimin e tyre, nxitjen e jetës komunitare, si dhe mbështetjen e aktivitetet dhe projektet e propozuara prej strukturave komunitare.
2. Bashkia inkurajon, fuqizon dhe mbështet të gjitha strukturat komunitare të përfitojnë në mënyrë të vazhdueshme nga Fondi.

KREU II

STRUKTURAVE KOMUNITARE DHE PALËT E INTERESUARA

Neni 9

Misioni i strukturave komunitare

1. Të përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe grupeve të interesit të lagjes apo fshatit dhe të përcjellin interesat dhe nevojat e komunitetit pranë bashkisë dhe aktorëve të tjerë, duke mundësuar ushtrimin e autoritetit sa më afër qytetarit.
2. Të mbështesin bashkinë për një qeverisje sa më të efektshme dhe efikase, si dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.
3. Të mbështesë zhvillimin vendor të udhëhequr nga komuniteti.
4. Të nxisin bashkinë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj nevojave të komuniteteve.
5. Të nxisin dhe mbështesin ndërtimin e kulturës dhe praktikave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis banorëve e bizneseve të lagjes apo fshati dhe bashkisë.
6. Të promovojnë rrjetëzimin, të nxisin ndërveprimin dhe të inkurajojnë vullnetarizmin në lagje apo fshat, për të mobilizuar kontribute në funksion të rritjes së mirëqënjes së komunitetit, arritjes së kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm territorit të lagjes apo fshatit
7. Të promovojnë dhe mbështesin bashkëjetesën dhe harmoninë në komunitet, dhe kohezionit shoqëror, për të përmirësuar cilësinë e jetës në lagje apo fshat.
8. Të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të lagjes apo fshatit.
9. Të zbusin polarizimin politik në komunitet.

Neni 10

Statusi i strukturave komunitare

1. Strukturat komunitare janë organizime vullnetare të komunitetit që ngrihen, zgjidhen dhe funksionojnë sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Strukturat komunitare janë të vetë-drejtuara, dhe të pavarura, përsa është e mundur.
3. Bashkia merr në konsideratë përgjigjen e kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar për kërkesa dërguar atyre për këshilla, rekomandime apo reagime në lidhje me vendime apo projekte e bashkisë që i ndikojnë direkt fshatit apo lagjes.
4. Përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe aktivitetit të tyre strukturat komunitare:
 - a. Mund të mbështesin funksionet e qeverisë së Bashkisë në lagjen apo fshatin e tyre.¹³

¹³ Ligji nr. 139/2015, neni 69/1; 71/1.

- b. Zbatojnë urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë,¹⁴ përsa kohë Bashkia vë në dispozicion të tyre burime, financiare, njerëzore, materiale dhe teknologjike.
- c. Vendosin vetë se cilat çështje janë të rëndësishme për lagjen apo fshatin që duan të përcjellin pranë Bashkisë, si dhe çfarë kontributi dëshirojnë të japin për vendimmarrësit e Bashkisë në lidhje me këto çështje.
- d. Marrin në shqyrtim dhe i përgjigjet me shkrim kërkesave të bashkisë për këshilla, rekomandime, komente apo reagime.

Neni 11

Palët e interesuara të strukturave komunitare

1. Strukturat komunitare janë të hapura për të gjithë banorët dhe palët e interesuara në lagje apo fshat.
2. Palët e interesuara janë banorët të fshatit apo lagjes, persona që punojnë ose zotërojnë pronë të paluajtshme në fshat apo lagje, apo janë anëtarë të një organizate komunitare, jo-qeveritare apo fetare që ka aktivitet periodik apo të përhershëm në territorin e lagjes apo fshatit.

Neni 12

Mandati i kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar

1. Mandati i kryesive të fshatrave është katër (4) vjeçar. Zgjedhjet e kryesive të fshatrave bëhen pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak, dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, Kryetari i Bashkisë emëron përkohësisht Kryetarin e Fshatit.¹⁵
2. Mandati i këshillave komunitarë është katër (4) vjeçar. Mandati fillon me zgjedhjen e këshillit komunitar të certifikuar dhe vazhdon deri në zgjedhjen e këshillit të ri komunitar.
3. Anëtari i Kryesisë apo Këshillit nuk mund të zgjidhet anëtar më shumë se dy mandate zgjedhore apo më gjatë se 8 vite të njëpasnjëshme.

Neni 13

Autoriteti i kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar

1. Në ushtrimin e autoritetit dhe funksioneve të tyre kryesitë e fshatit dhe këshillit komunitarë:
 - a. Kryejnë funksione apo kompetenca të deleguara nga Këshilli Bashkiak, e në këtë rast, Këshilli Bashkiak vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e strukturave komunitare¹⁶.

¹⁴ Ligji nr. 139/2015, neni 71/5.

¹⁵ Ligji nr. 139/2015, neni 70/4.

¹⁶ Ligji nr. 139/2015, neni 69/2; 70/1.

- b. Monitorojnë aspekte të cilësisë dhe sasisë së ofrimit të shërbimeve publike dhe zbatimin e projekteve në lagjen dhe fshatin e tyre. Për këtë qëllim, Bashkia vë në dispozicion të tyre, sipas kërkesës, çdo dokumentacion të nevojshëm për të realizuar monitorimin.
 - c. Mund të iniciojnë, zbatojnë dhe mbështesin projekte për përmirësimin fizik, social dhe kulturor të zonës dhe në dobi e përfitim të komunitetit të lagjes apo fshatit e tyre.¹⁷
 - d. Ofrojnë këshilla për Këshillin dhe Kryetarin e Bashkinë për çështje me interes të bashkisë, apo të lagjes dhe fshatit.
 - e. Lehtësojnë komunikimin mes Bashkisë dhe palëve të interesit në komunitet për çështje që shqetësojnë komunitetin dhe apoose palët e interesit.
 - f. Njoftojnë paraprakisht komunitetin për nisjen e procesit vendimtarës të Bashkisë për çështje që kanë ndikim në jetën e komunitetit dhe në territorin që ato mbulojnë. Ndërkohë përcjellin çdo rekomantim, vërejtje dhe sygjerim të komunitetit në drejtim të Bashkisë përpara vendimmarrjes përfundimtare për këto çështje.
2. Gjatë ushtrimit të kompetencave dhe zbatimit të detyrave, strukturat komunitare dhe anëtarët e tyre respektojnë kërkesat ligjore për të të drejtën e informacionit për dokumentet zyrtare, rregulloren e etikës dhe kodin e sjelljes së miratuar nga Këshilli Bashkiak, kërkesat e ligjit nr. 139/2015 dhe të rreguloren së miratuar nga Këshilli Bashkiak për konfliktin e interes.

Neni 14

Roli i kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar

1. Promovojnë, nxisin, dhe mbështesin pjesëmarrjen dhe angazhimin e komunitetit dhe grupeve të interesit në politikëbërjen dhe vendimmarrjen e Bashkisë të cilat i ndikojnë banorëve, bizneseve dhe territorit të lagjes apo fshatit.
2. Mbështesin iniciativat komunitare me qëllim kultivimin e kulturës të bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes me Bashkinë.
3. Nxisin dhe mbështesin përfshirjen e grupeve vulnerabël në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Bashkisë.
4. Promovojnë llogaridhënjen në nivel komunitare të politikave dhe vendimmarrjes të Bashkisë.
5. Nxisin dhe mbështesin bashkëpunimin midis komunitetit dhe OJF-ve.
6. Inkurajojnë dhe mbështesin iniciimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve komunitare.

¹⁷ Ligji nr. 139/2015, neni 69/1; 70/1.

KREU III

ORGANET E STRUKTURAVE KOMUNITARE

Neni 15

1. Organet e strukturës komunitare në fshat janë Kryesia dhe Kryetari i Fshatit.
2. Organet e strukturës komunitare në lagje janë Këshilli dhe Ndërlidhësi Komunitar

Neni 16

Anëtarësia e kryesisë dhe e këshillit komunitar

1. Kryesia e Fshatit dhe Këshilli Komunitar përbëhen nga banorë në lagjen apo fshatit.¹⁸
2. Anëtarët e zgjedhur nga secila lagje e fshatit janë banorë të lagjes, dhe përbëjnë Kryesinë e Fshatit.
3. Këshilli bashkiak miraton numrin e anëtarëve të kryesisë për çdo fshat dhe lagje. Në çdo rast numri i anëtarëve të kryesisë apo këshillit, të përcaktuar është numër tek
4. Anëtarësia, përsa është e mundur, duhet të pasqyrojë interesat e larmishme brenda lagjes apo fshatit, dhe duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe e hapur për të gjithë grupet e interesit pjesë të komunitetit.
5. Asnjë grup interesi i komunitetit nuk mund të përbëjë shumicën e anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit Komunitar.
6. Këshilli Komunitar përbëhet banorë të lagjes që i përkasin katër kategorive të palëve të interesuara: i) banorë që zotërojnë apo jo një pronë të palujtshme, ii) banorë që janë pronarë të bizneseve në lagje, iii) banorë që janë anëtarë të një organizate komunitare, jo-fitimprurëse, jo-qeveritare apo fetare, punonjës të institucioneve arsimore parauniversitare të cilat kanë një adresë sëpaku për një periudhë një (1) vjeçare brenda kufijve të territorit të lagjes dhe ushtrojnë aktivitet të verifikueshëm dhe me përfitime direkte për komunitetin e lagjes, iv) banorë në moshë të re (nga mosha 18 - 25 vjeç). Çdo zonë e lagjes duhet të zgjedhë së paku nga një (1) përfaqësues të secilës kategori në Këshillin Komunitar.

Neni 17

Kufizimet e mandatit të anëtarit të kryesisë apo këshillit

1. Një person nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një Kryesie apo Këshilli Komunitar.
2. Nuk mund të jenë anëtarë të së njëjtës Kryesie apo Këshilli personat e lidhur: bashkëshortë, bashkëjetues, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin, bashkëjetuesi aposja, kushërinjë e parë, dajallarë e xhaxhallarë me nipa dhe mbesa, halla e teze me nipër e mbesa.
3. Nuk mund të jenë anëtarë të Kryesisë apo Këshillit persona që mbajnë pozicionin e të zgjedhurit vendor në Bashki, kryetare apo zëvendëskryetar i bashkisë, sekretar i këshillit bashkiak, nëpunës civil të administratës së bashkisë, titullarë të institucioneve dhe drejtues

¹⁸ Ligji nr. 139/2015, neni 68/1; 70/1.

të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë, deputetë, prefekti i qakut, kryetari i këshilli të qarkut, ministër, zëvendësministër, drejtuesi i një agjencive qeveritare qendrore në nivel qarku, si dhe drejtuesi i një institucioni shtetëror kombëtar.

4. Nëse kandidatët fitues në një Kryesi apo Këshill kanë lidhje familiare, sipas pikës një (1) të këtij neni, kandidati që ka marrë me shumë vota merr mandatin, ndërkohë personit me lidhje familiare i hiqet mandati dhe vendin e tij e zë kandidati i listës i cili ka marrë më shumë vota. Nëse të dy kandidatët fitues kanë të njëjtin numër votash, hidhet short nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, dhe fituesit i jepet mandati.
5. Personat në lidhje familiare, sipas pikës një (1) të këtij neni, nuk mund të jenë anëtarë të njëkohshëm të disa Kryesive të Fshatrave apo Këshillave Komunitarë. Kandidatit që ka marrë më shumë vota i jepet mandati, ndërsa familiarit të tij i hiqet mandati dhe vendin e tij e zë kandidati i listës, i cili ka marrë me shumë vota. Nëse të dy kandidatët fitues kanë të njëjtin numër votash, hidhet short nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, dhe fituesit i jepet mandati.

Neni 18

Mungesat në detyrë e anëtarit të kryesisë apo këshillit

1. Çdo anëtar i Kryesisë apo Këshillit Komunitar që mungon në tre (3) mbledhje të rregullta në një periudhë gjashtë (6) mujore ose në katër (4) mbledhje të rregullta brenda një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore, pavarësisht nëse ka marrë leje apo jo nga Kryetari apo Ndërmjetësi, apo është i pamundur të marrë pjesë për arsye shëndetësore, humbet mandatin si anëtar i Kryesisë apo Këshillit. Nëse mbas kësaj periudhe anëtari i bën kërkesë me shkrim Kryesisë apo Këshillit për t'u kthyer në pozicionin e anëtarit, Kryesia apo Këshilli i rikthen mandatin pa debat, nëse vendi i anëtarit është akoma bosh.
2. Anëtari konsiderohet se ka munguar edhe kur vjen në mbledhje mbasi është bërë votimi për pikën e fundit të rendit të ditës të njoftuar publikisht. Kjo shënohet në procesverbalin e mbledhjes.
3. Mos pjesëmarrja e një anëtari në mbledhjen e Kryesisë apo Këshillit nuk konsiderohet mungesë nëse anëtari ka marrë leje paraprakisht për arsye të pjesëmarrjes në një aktivitet tjetër të autorizuar me shkrim nga Kryetari apo Ndërlidhësi apo Kryesia apo Këshilli. Në këtë rast në procesverbalin e mbledhjes shënohet se anëtari nuk ka munguar, për efekt të legjitimitetit të mandatit, dhe citohet aktiviteti ku anëtari merr pjesë.
4. Pas mungesave të bëra sa më sipër Kryesia apo Këshillit shprehen me vendim për mbarimin e mandatit të anëtarit dhe vendimin ia njofton Këshillit Bashkiak. Nëse Kryesia apo Këshillit nuk shprehen me vendim për mbarimin e mandatit të anëtarit, Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi ia përcjell çështjen për shqyrtim dhe vendim Këshillit Bashkiak, cili e shqyrton kërkesën në mbledhjen më të parë të radhës. Në rast se mungesa është bërë nga Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak mund të bëhen nga çdo anëtar i Kryesisë apo Këshillit, apo nëpërmjet një peticioni të nënshkruar nga një grup banorësh të lagjes apo fshatit përkatës.

Neni 19

Përfundimi i mandatit të anëtarit të Kryesisë apo Këshillit

1. Mandati i anëtarit të Kryesisë apo Këshillit mbaron përpara afatit kur:
 - a. Jep dorëheqjen
 - b. Vdes
 - c. Shkarkohet nga Kryesia e Fshatit apo Këshilli
 - d. Shkarkohet nga Këshilli Bashkiak.
 - e. Nuk plotëson më kushtet e kësaj rregulloreje që i kërkohen kandidatit për anëtar të Kryesisë apo Këshillit.
 - f. Dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
 - g. Humbet zotësinë për të vepruar, me vendim gjykate të formës së prerë.
2. Kryetarit të Fshatit shkarkohet për performance të dobët nga Kryetari i Bashkisë, nëse ky i fundit e ka qënë autoriteti i emërtesës. Në rast të zgjedhjes së kryetarit të fshatit nga Kryesia e Fshatit shkarkimi i kryetarit të fshatit të emëruar bëhet një ditë mbas vendimit të Kryesisë së Fshatit për zgjedhjen e Kryetarit të Fshatit.
3. Shkarkimi i anëtarit të Kryesisë apo Këshillit bëhet me propozim të:
 - a. Një apo disa anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit. Propozuesi/t mund të bëjnë mocion për shkarkimin e një anëtarit, për arsye të, por pa u kufizuar: i) pengimin e punës së Kryesisë apo Këshillit; ii) shkeljen e akteve nënligjore dhe të procedurave të funksionimit të stukturës komunitare; iii) shkeljen e kodit të sjelljes. Mocioni përfshin: i) identitetin e anëtarit që kërkohet të shkarkohet, ii) një përshkrim të detajuar të arsyeve shkarkimit, dhe iii) nënshkrimet e të paktën dy (2) anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit.
 - b. Një grup prej jo më pak se pesëdhjetë (50) banorësh, të cilët dorëzojnë pranë Kryesisë apo Këshillit një peticioni për shkarkimin e një anëtarit të Kryesisë apo Këshillit. Peticioni duhet të përmbajë: i) identitetin e anëtarit që kërkohet të shkarkohet, ii) një përshkrim të detajuar të arsyeve të shkarkimit, dhe iii) nënshkrimet e vlefshme të banorëve. Peticioni shqyrtohet në mbledhjen më të parë të rregullt të Kryesisë apo Këshillit, nga data e dorëzimit të peticionit.
 - c. Shkarkimi i anëtarit bëhet me votën Pro të të paktën dy të tretave (2/3) të anëtarëve. Anëtarit që është subjekt i shkarkimit ka të drejtë të dëgjohet në mbledhjen e Kryesisë apo Këshillit, por nuk do të llogaritet si pjesë e kuorumit, dhe as nuk lejohet të votojë për këtë çështje. Anëtarit mund të paraqesë ankesë në Këshillin Bashkiak për vendimin e shkarkimit të Kryesisë apo Këshillit, e cili e shqyrton në mbledhjen më të parë nga data e regjistrimit të ankesës në Bashki.
 - d. Vendimi për shkarkimin e anëtarit të Kryesisë apo Këshillit hyn në fuqi menjëherë, dhe Kryetari apo Ndërlidhësi i dërgon anëtarit të shkarkuar njoftimin bashkë me një kopje të vendimit, jo më vonë se pesë (5) ditë nga marrja e vendimit. Një kopje e vendimit për shkarkimin e anëtarit të Kryesisë apo Këshillit i dërgohet Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë.
4. Anëtarit të Kryesisë apo Këshillit mund të japë dorëheqjen duke i paraqitur Kryesisë apo Këshillit një kërkesë më shkrim për dorëheqje, e që nga ai moment pozicioni i anëtarit do të konsiderohet i lirë.

5. Nëse një anëtar nuk kualifikohet më për të mbajtur pozicionin e anëtarit të Kryesisë apo Këshillit, përgjatë pjesës së mbetur të mandatit të tij, për shkak të papajtueshmërisë që mund të krijohet gjatë ushtrimit të mandatit, ai duhet të njoftojë menjëherë Kryesinë apo Këshillin. Përfaqësimi i tij në pozicionin e anëtarit të Kryesisë apo Këshillit pushon menjëherë në ditën e paraqitjes së njoftimit në mbledhjen e Kryesisë apo Këshillit, dhe nga kjo ditë pozicioni konsiderohet i lirë.

Neni 20

Vendet e lira në kryesi dhe këshill

1. Në rastet kur në Kryesi apo Këshill krijohen vende të lira, sipas parashikimeve në nenin 19 më sipër, zëvendësimi i anëtarit bëhen sipas procesit zgjedhor dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Në rastet kur Kryesia e Fshatit ka të lira 2 nga 3 zgjedhjet bëhen për të gjithë fshatin. Kryetari i Fshatit njofton me shkrim këshillin bashkiak për vendet e lira. Vendi i lirë në Kryesinë e Fshatit plotësohet nga kandidati i radhës në listën e lagjes së fshatit. Nëse nuk ka kandidatë të mbetur, Kryesia vendos plotësimin e vendit të lirë duke respektuar listën e kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në zgjedhjet e fundit për Kryesinë. Kryesia ia njoftin vendimin Këshillit Bashkiak.
3. Në rastin e vendit të lirë në një Këshill Komunitar, Sekretari i Këshillit shpall vendin e lirë në faqen e internetit të Bashkisë, ndërkohë Ndërlidhësi e vendos njoftimin publik në mjediset publike të godinës së NjA, brenda së cilës ndodhet lagjia, dhe në sëpaku një zonë të tjetër ku nuk ndodhet godina e NjA. Aplikimet për vendin e lirë duhte të dorëzohen tek Sekretari i Këshillit Bashkiak brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi publik i vendit të lirë. Sekretari i Këshillit njofton Këshillin Komunitar për çdo kandidat të kualifikuar, që ka paraqitur një kërkesë. Këshillin Komunitar merr vendim për miratimin apo refuzimin e kërkesës apo kërkesave për anëtar të Këshillit. Nëse asnjë aplikim nuk është bërë për të plotësuar vendin e lirë, Këshilli vendos emërimin e kandidatit sipas listës së kandidatëve të zonës së lagjes që kanë marrë më shumë vota në zgjedhjet e fundit për Këshillin, dhe brenda kategorisë përkatëse, dhe nëse kjo nuk është e mundur, sipas listës së kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në nivel lagjie, në zgjedhjet e fundit për Këshillin. Këshilli ia njofton vendimin Këshillit Bashkiak.
4. Në çdo rast Kryesia apo Këshilli nuk mund të plotësojë vendet e lira në përse kohë shumica e të gjithë vendeve të anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit janë të plotësuar.
5. Plotësimi i një vendi të lirë të anëtarit të Kryesisë apo Këshillit apo nuk lejohet nëse mandati i Kryesisë apo Këshillit mbaron brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data që kërkesa me shkrim e kandidatit i është paraqitur Kryesisë apo Këshillit.
3. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundimin e periudhës së mbetur të mandatit të Kryesisë apo Këshillit.¹⁹

Neni 21

¹⁹ Ligji nr. 139/2015, neni 70/4.

Komisionet e kryesive apo këshillave

1. Kryesitë apo Këshillat mund të ngrejnjë komisionet e tyre të përhershme të cilët kanë juridiksion të vazhdueshëm të çështjes lëndore që i është caktuar nga Kryesia apo Këshilli.
2. Komisionet **mund të jenë**: i) Komisioni i Buxhetit, i cili mblidhet jo më radhë se çdo tre muaj, dhe rishikon raportet financiare, harton buxhetin vjetor, dhe i paraqet Kryesisë apo Këshillit kërkesat për fonde dhe raportet financiare; ii) Komiteti i Mandateve dhe Rregullores, i cili është përgjegjës për rishikimin dhe rekomandimin e ndryshimeve të të gjitha rregullave dhe rregulloreve me të cilat punon Kryesia apo Këshilli, duke përfshirë por jo kufizuar në miratimin dhe rishikimin rregullave të funksionimit të Kryesisë apo Këshillit; iii) Komiteti i Shtirjes në Ndërveprim me Komunitet, i cili i raporton mbledhjes së Kryesisë apo Këshillit për përpjekjet dhe aktivitetet për ndërveprimin me komunitetin, metodat dhe rezultatet për komunikimin dhe informimin e komunitetit, si dhe projektet e parashikuara; iv) Komiteti i Kontrollit të Territorit dhe Mbikqyrjes së Shërbimeve Publike, i cili monitoron menaxhimin e territorit, si promovon standartet dhe mbikqyr cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike dhe zbatimin e projekteve infrastrukturore në territorin e lagjes apofshatit.
3. Kryetarët e Komisioneve emërohen nga Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi, dhe Kryesia apo Këshilli miraton anëtarësinë e Komisioneve. Anëtarët e komisionit largohen nga komisioni në të njëjtën mënyre që emërohen.
4. Kryetari i komisionit mundëson mbajtjen e procesverbalit në çdo mbledhjeje të Komisionit, dhe i paraqet Kryesisë apo Këshillit raportin e mbledhjes. Procesverbalet e mbledhjeve miratohen në çdo mbledhje të Komisionit. Minutat e miratuara dhe rendi i ditës së mbledhjes së Komisionit i paraqiten Kryetarit të Fshatit apo Ndërlidhësit.
5. I gjithë dokumentacioni i mbledhjeve të komisionit i dorëzohet Kryetarit të Fshatit apo Ndërlidhësit, mbas çdo mbledhjeje të komisionit.
6. Komisionet i referohen kësaj rregulloreje dhe rregullores së funksionimit të Këshilli Bashkiak për rregullat dhe procedurat e organizimit dhe mbajtjes së mbledhjeve.

Neni 22

Mbrojtja ndaj përgjegjësive publike

1. Anëtarët e Kryesisë apo Këshillit për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave që u ngarkohen me ligj apo me vendim të Këshillit Bashkiak mbrohet në gjykatë nga drejtoria/sektori juridik i Bashkisë.
2. Paditë gjyqësore ndaj Kryetarit të Fshatit apo Ndërlidhësit gjatë ushtrimit të detyrës mbrohen në Gjykatë nga drejtoria/sektori juridik i Bashkisë.

Neni 23

Kufizimet e veprimeve të organeve të strukturave komunitare

1. Anëtarët Kryesisë apo Këshilli, si dhe Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit, nuk kanë të drejtë, që ndaj Bashkisë, si dhe ndaj institucioneve e ndërmartjeve në vartësi të Bashkisë:

- a. Të ngrenë padi gjyqësore.
 - b. Të dërgojnë ankim administrative ndaj vendimeve dhe veprimeve të tyre.
2. Gjithësesi, anëtarët Kryesisë apo Këshilli, si dhe Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit, në kapacitetin e tyre si qytetarë, mund të ngrenë padi gjyqësore apo të dërgojnë ankim administrativ ndaj vendimeve dhe veprimeve të bashkisë dhe organeve të saj, si dhe ndaj institucioneve e ndërmarrjeve në vartësi të bashkisë.

Neni 24

Financat dhe buxheti i strukturës komunitare

1. Kryesia dhe Këshilli krye funksione apo kompetenca të deleguar nga Këshilli Bashkiak si dhe zbaton projekte me financimin apo bashkëfinancimin e Këshilli Bashkiak, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.²⁰
2. Kryesitë dhe Kryetarët e Fshatrave dhe Këshillat dhe Ndërlidhësit Komunitarë mund të shpenzojnë fonde vetëm për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjesive të dhëna atyre me ligj, me këtë rregullore apo me vendim të Këshillit Bashkiak, dhe në çdo rast vetëm për qëllime publike të lagjes dhe fshatit. Ato mund të shpenzojnë fonde që lidhen me shpenzimet operative dhe të zgjedhjeve të organeve të strukturave komunitare, për komunikimin dhe shtrirjen e ndërveprimit të strukturave komunitare me komunitetin, si dhe projektet për zhvillimin e komunitetit dhe të territorit të lagjes dhe fshatit.
3. Për të realizuar funksionet, detyrat dhe përgjegjesitë e përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, Kryesitë dhe Këshillat kanë të drejtë të hartojë dhe zbatojë buxhetin e vet. Në këtë rast Kryesitë dhe Këshillat duhet të ngrejë një sistem të menaxhimit dhe llogaridhënjes financiare që rregullon përdorimin e fondeve që përdoren nga struktura komunitare, si dhe duhet të punësojë, me kohë të plotë apo të pjesëshme, një specialist financiar për menaxhimin financiar, Specialisti do të mbajë librin e llogarive, do të hartojë raportin financiar, do të bëjë pagesat, do t'i dërgojë dokumentet financiare njësisë së fuqizimit dhe zhvillimit të komuniteteve, për t'ja përcjellë drejtorisë apo sektorit të financave të bashkisë, si dhe do të zbatojë detyra të tjera që lidhen me këtë pozicion.
4. Kryesitë dhe Kryetarët e Fshatrave dhe Këshillat dhe Ndërlidhësit Komunitarë nuk mund të shpenzojnë fonde publike për të lobuar palët e interesuara për të mbështetur qëndrimin e Kryesive apo Këshillave përkatës për rekomandimet që këto të fundit bëjnë pranë Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë.
5. Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit sigurojnë një proces transparent të menaxhimit financiar që i mundëson komunitetit të lagjes apo fshatit të kenë qasje në librat e llogarive që administrohet nga Kryesitë apo Këshillat.
6. Kryesitë apo Këshillat që aplikojnë apo përfitojnë fonde nga Bashkia duhet të:
 - a. miratojnë buxhin vjetor sipas rregullave dhe standarteve financiare;
 - b. raportojë rregullisht për financat në mbledhjet e Kryesisë apo Këshillit;
 - c. mundësojë auditimin financiar të fondeve të përdorura, çdo 4 muaj;
 - d. ngrejë komisionin për buxhetin dhe financën, i cili mblidhet sëpaku çdo tre muaj.

²⁰ Ligji nr. 139/2015, neni 69/2.

7. Bashkia mundëson rritjen e kapaciteteve të Kryesive dhe Këshillave, si dhe të punonjësve të tyre, për hartimin dhe raportimin mujor e vjetor të zbatimi të buxhetit për projektet e financuara nga Bashkia.
8. Këshilli Bashkiak miraton udhëzuesin operacional për përdorimin e fondeve të Bashkisë nga Kryesitë apo Këshillat si dhe manualin e aplikimit tek Fondi.
9. Këshill dhe Kryesia auditohet nga bashkia për fondet dhëna nga bashkia, dhe sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Trajnimi i anëtarëve të kryesive apo këshillave

1. Të gjithë anëtarët e Kryesive apo Këshillave duhet të marrin trajnime bazë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në çështjet e etikës, konfliktin e interesit, ngritjen e fondeve, financimin e projekteve, hartimin e buxhetit, mbykqyrjen e zbatimit të buxhetit, mbajtjen e mbledhjeve, informimin, konsultimin dhe angazhimin e komunitetit.
2. Bashkia duhet të mundësojë trajnimet anëtarët e Kryesive apo Këshillave brenda një viti, duke filluar nga dyzet e pesë (45) ditë nga zgjedhja si anëtarë të Kryesisë apo Këshillit.

KREU IV

PËRGJEGJËSITË E KRYESISË APO KËSHILLIT KOMUNITAR

Neni 26

Përgjegjësitë e kryesisë apo këshillit

1. Kryesitë e Fshatrave apo Këshillat Komunitarë mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në lagje apo fshat.²¹
2. Kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në fshat apo lagje.²²
3. Nxisin dhe organizojnë pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e politikëbërjes dhe konsultimeve publike të njoftuara nga Bashkia.
4. Hartojnë raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për fshatin apo lagjen dhe miratojnë listën vjetore të përparësive për investime në fshat apo lagje, dhe ia propozojnë bashkisë për t'i përfshirë në buxhetin vjetor.
5. Këshillojnë Bashkinë në lidhje me çështjet që i ndikojnë komuniteti, biznesit dhe territorit të lagjes apo fshatit.
6. Identifikojnë investimeve të parashikuara në projekt buxhetin afatmesëm dhe vjetor të bashkisë në territorin e fshatit apo lagjes, dhe dërgojnë kryetarit të bashkisë reagimet dhe rekomandimet për këto investime.
7. Përgatisin komentet, rekomandimet, propozimet apo reagimet ndaj kërkesa të bashkisë ndrejtur Kryesisë apo Këshillit në lidhje me politikën, vendimet dhe projektet zhvillimore

²¹ Ligji nr.139/2015, nenet 69/1; 71/1.

²² Ligji 139//2015, neni 71/1.

të bashkisë në territorin e fshatit apo lagjes, dhe i dorëzojnë ato përpara se të merren vendime për çështje përkatëse.

8. Shërbejnë si grup këshillimi dhe monitorimi për investimet e bëra në fshat apo lagje nga Bashkia apo aktorë të tjerë.
9. Rekomandojnë me shkrim ndërmarrjen e një veprimi apo hartimin e një politike ose plani në interes dhe dobi të komunitetit apo territorit të fshatit apo lagjes.
10. Miratojnë aplikimin për projekte tek Fondi.
11. Mundësojnë dhe lehtësojnë qasjen në informacione dhe të dhëna që administrohen nga Bashkia apo agjencie të tjera qeveritare, të cilat i shërbejnë komunitetit dhe punës së Kryesisë apo Këshillit.
12. Komunikojnë dhe bashkëpunojnë me bashkinë në lidhje me çështje të rëndësishme si shërbimet dhe infrastruktura publike, të pastrehët dhe njerëzit në nevojë, kontrolli i territorit dhe përballimi i emergjencave në territorin e lagjes apo fshatit.
13. Ndihmojnë në parandalimin dhe ndërmjetësimin e konflikteve në komunitet.
14. Ndihmojnë në organizimin e takimeve publike të mbajtura nga bashkia që kanë të bëjnë me çështje dhe projekte të rëndësishme që i ndikojnë fshatit apo lagjes.
15. Nxisin komunitetin dhe marrin pjesë në dëgjesat publike të organizuara nga Këshilli Bashkiak, për çështje apo projekte që i ndikojnë fshatit apo lagjes.
16. Nxisin dhe mbështesin peticione për nxitjen e vendimeve apo rrëzimin e propozimeve, të cilat bien ndesh me interesat e banorëve dhe territorit të fshatit apo lagjes.
17. Monitorojnë cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike dhe projekteve apo investimeve të bashkisë apo aktorëve të tjerë në zonat e fshatit apo lagjes.
18. Nxisin dhe mbështesin aksione komunitare me qëllim për të siguruar burimeve financiare dhe materiale në ndihmë të komunitetit apo zhvillimit të territorit.
19. Kryesia e fshatit kujdeset për administrimin e varrezave të fshatit, bazuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë.²³

Neni 27

Detyrat e kryetarit të fshatit apo ndërmjetësit

1. Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi mbështet funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në lagje apo fshat.²⁴
2. I dërgon Kryetarit të Bashkisë listën e përparësive për investime në fshat apo lagje, dhe brënda afatit të përcaktuar nga ky i fundit. Një kopje të listës Kryetari apo Ndërmjetësi e bën publike në mjediset e përcaktuara për njoftime publike në fshat apo lagje.
3. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo të komisioneve të përhershme të tij, ose merr pjesë në to me nismën e tij, dhe ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje që i ndikojnë fshatit apo lagjes.

²³ Ligji nr. 139/2015, neni 71/2.

²⁴ Ligji nr.139/2015, nenet 69/1; 71/1.

4. Drejton dhe organizon punën për zbatimin e detyrave dhe projekteve që Bashkia i ka deleguar Kryesisë apo Këshillit.²⁵
5. Mundëson hartimin e projekt propozimeve dhe dorëzon në bashki aplikimet për financim nga Fondit Vjetor i Bashkisë për Fuqizimin dhe Zhvillimin e Komuniteteve.
6. Ndjek, sipas rastit, zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkia, apo aktorë të tjerë në prona apo mjedise në pronësi të Bashkisë.
7. Zhvillojnë takime periodike me administratorin e NjA apo zyrtarë përgjegjës të drejtorive të Bashkisë për problematika në lidhje me sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike në territorin e lagjes apo fshatit.
8. Bashkëpunon me administratorin e NjA apo zyrtarë përgjegjës të administratës së bashkisë për të gjitha çështjet që lidhen me problematikat dhe zhvillimin të komunitetit dhe territorit në lagje apo fshat.
9. Marrin pjesë në dëgjuesat publike të organizuara nga Këshilli Bashkiak, për çështje apo projekte që i ndikojnë fshatit apo lagjes.
10. Paraqesin në mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo në takimet e organizuara nga Kryetari i Bashkisë, mendimet apo komentet e Kryetarit të Fshatit apo Ndërlidhësit paraqiten në Mbledhjen e Këshillit Bashkiak.
11. Dërgon pranë Bashkisë ankesa për cilësinë dhe sasinë së shërbime publike të ofruara në territorin e lagjes apo fshatit, si dhe shqetësimet e komunitetit dhe biznesit për këto shërbime.
12. Informon në mënyrë të vazhdueshme komunitetin për aktivitetet e Kryesisë apo Këshillit.
13. Merr pjesë në grupet e punës në nivel lagje apo fshati, për përballimin e situatave nga fatkeqësitë natyrore, shëndetësore, apo të tjera, sipas vendimit të Këshillit apo Kryetarit të Bashkisë.
14. Jep mendimin për gjendjen social ekonomike të familjeve në fshat apo lagje, kur kjo i kërkohet nga bashkia.
15. Drejton dhe organizon punën e Kryesisë apo të Këshillit Komunitar.²⁶
 - a. Përgatit rendin e ditës në bashkëpunim me Bashkinë dhe të kryeson të gjitha mbledhjet e Kryesisë apo Këshillit.
 - b. Thërret dhe organizon mbledhje të Kryesisë apo Këshillit.
 - c. Mbikëqyr mbajtjen dhe zbardhjen e procesverbalit të mbledhjeve të Kryesisë apo Këshillit.
 - d. Emëron Kryetarët e Komiteteve të Kryesisë apo Këshillit, që më pas miratohen nga Kryesia apo Këshilli.
 - e. Shërben si zëdhënës dhe përfaqësues i Kryesisë apo Këshillit.
 - f. Përfaqësojnë Kryesisë apo Këshillit në mbledhjet e Ekzekutivit të Bashkisë si dhe me Kryesisë apo Këshillat e tjerë, dhe me aktorë të tjerë.

²⁵ Ligji nr. 139/2015, 69/1.

²⁶ Ligji nr.139/2015, nenet 68; 70/3.

- g. Informon Kryesinë apo Këshillin për takimeve dhe aktivitetete të fshat apo lagje
 - h. Mbikëqyr përgatitjen dhe deklaratat në emër të Kryesisë apo Këshillit.
 - i. Bën deklaratat para mediave, në emër të Kryesisë apo Këshillit.
 - j. Njofton mediat vendore për aktivitetet dhe ngjarjet e Kryesisë apo Këshillit.
 - k. Krijon dhe të mban komunikim me banorët, organizatat dhe bizneset vendore në përpjekje për të rritur mbështetjen për Kryesinë apo Këshillin si dhe përfshirjen e komunitetit në vendimarrjen e Këshillit apo Kryesisë, si dhe të Këshilli Bashkisak.
 - l. Mban korrespondencën në emër të Kryesisë apo Këshillit.
 - m. Firmosë vendimet e Kryesisë apo Këshillit.
 - n. Mbikëqyr faqen e internetit Kryesisë apo Këshillit.
16. Bazuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, Kryetari i Fshatit mund të kryejnë edhe detyrat si më poshtë:²⁷
- a. Kujdeset për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit.
 - b. Kujdeset për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdolloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike në fshat.
 - c. Në fshatra ku nuk ka zyrë të gjendjes civile, Kryetari i Fshatit jep lejen për varrim, dhe në këtë rast, Kryetari i Fshatit, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.²⁸
 - d. Kujdeset për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, të rezervuarëve, të burimeve natyrore, si dhe të çdo prone në pronësi të Bashkisë.
17. Ushtron dhe detyra të tjera të ngarkuara nga Kryesia apo Këshilli Komunitar, apo të deleguara nga Këshilli i Bashkisë, për sa kohë janë në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore.
18. Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi mund të shpërblehet për punën që kryejnë sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.²⁹ Shpërblimi është dhjetë përqind (10%) të pagës së administratorit të NjA apo Kryetarit të Bashkisë.³⁰

²⁷ Ligji nr. 139/2015, neni 71/2.

²⁸ Ligji 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, neni 52/ 7, i përditesuar.

²⁹ Ligji nr. 139/2015, neni 69/3; 71/6.

³⁰ VKM nr. 165, datë 2.3.2016, pika 16 dhe 17.

KAPITULLI III

INICIATIVA PER NGRITJEN E KËSHILLIT KOMUNITAR

KREU I

TERRITORI DHE ANËTARËSA E KËSHILLIT KOMUNITAR

Neni 28

Paraqitja e iniciativës

1. Këshilli Komunitar në lagje ngrihet dhe funksionon në bazë të iniciativës qytetare dhe organizohet mbi baza vullnetare.³¹
2. Iniciativa qytetare për ngritjen e Këshillit Komunitar i drejtohet Këshillit Bashkiak nga jo më pak se një për qind (1%) e banorëve të lagjes,³² apo një për qind (1%) e numrin të banorëve të të gjithë zonave që propozohen të përfshihen në juridiksionin e Këshillit Komunitar.

Neni 29

Territori i këshillit komunitar

1. Këshilli Bashkiak përcakton zonat brënda lagjes dhe kufijtë përkatës, **por jo më shumë se 4 zona, për lagje.**
2. Këshilli Bashkiak mund të vendosë krijimin në një lagje të më shumë se dy Këshilla ose bashkimin e Këshillave të dy apo më shumë lagjeve.³³ Numri minimal i banorëve të lagjes ku themelohet Këshilli Komunitar është 5,000 apo 10,000 apo 15,000 apo 20,000 banorë,³⁴ (shënim- në varësi të madhësisë së bashkisë).
3. Këshilli mund të përcaktojë edhe zonat e një lagjeje që mund të përfshihen në juridiksionin e një Këshilli. Çdo zonë ka minimumi 500 apo 1000 dhe maksimumi 2000 apo 3000 banorë të regjistruar (shënim: numri mund të ndryshojë në bashki të ndryshme në varësi të numrit të banorëve të regjistruar në secilën zonë).
4. Në përcaktimin e zonave Këshilli Bashkiak merr parasysh element të ndryshëm gjeografikë si rrugë, sheshe, lumej, ura, si dhe vëndndodhjen e shkollave, institucioneve publike bashkiake, institucione të tjera të shërbimeve administrative, kulturore, sportive si dhe territore të zonave që janë parqe apo sheshe publike.

Neni 30

Numri i anëtarëve të këshillit komunitar

1. Këshilli Bashkiak përcakton me vendim numrin e anëtarëve të Këshillit Komunitar të një lagjes dhe numrin e anëtarëve të Këshillit Komunitar **që do të zgjidhen në çdo zonë të**

³¹ Ligji nr. 139/2015, neni 68/1.

³² Ligji nr. 139/2015, neni 20/1.

³³ Ligji nr. 139/2015, neni 68/4.

³⁴ Ligji nr. 139/2015, neni 6/3 – “Lagjia, si rregull, krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë”.

asaj lagje, si dhe përcakton numrin e anëtarëve të Këshillit Komunitar në rast se ai ka në juridiksion disa zona të lagjes.

2. Në përcaktimin e numrit të anëtarëve të Këshillit Komunitar për secilën zonë, Këshilli Bashkiak merr parasysh, por jo vetëm, numrin e banorëve dhe bizneseve të regjistruar në zonë.

KREU II

CERTIFIKIMI I INICIATIVËS PËR NGRITJEN E KËSHILLIT KOMUNITAR

Neni 31

Qëllimi i certifikimit

1. Iniciativat qytetare që praqiten pranë Këshillit Bashkiak për të miratuar ngritjen e një Këshilli Komunitar, certifikohen sipas kërkesave dhe procedurave të kësaj rregulloreje.
2. Këshilli Bashkiak nëpërmjet certifikimit të iniciativës qytetare, njeh zyrtarisht territorin e propozuar nga iniciativa dhe autorizon ngritjen e strukturës komunitare në territorin e një lagje, në një pjesë të saj, apo në territorin e më shumë se një lagje.
3. Të gjitha aplikimet për certifikim do të paraqiten me shkrim, sipas kërkesave dhe në formatin e përcaktuar nga kjo rregulloreje dhe rregullores së Këshillit Bashkiak për peticionet dhe iniciativat qytetare.

Neni 32

Kërkesat për certifikim

1. Aplikimi duhet plotësojë minimumi kërkesat e mëposhtme për t'u certifikuar:
 - a. Parashtruesit e iniciativës duhet të mbledhin nënshkrimet e jo më pak se një përqind (1%) e numrit të banorëve të regjistruar të lagjes apo zonave ku propozohet të ngrihet Këshilli Komunitar, dhe jo më shumë se pesëdhjetë (50) nënshkrime më shumë se numri minimal i kërkuar.
 - b. Nënshkrimet duhet të pasqyrojnë një llojshmëri sa më të gjerë të palëve të interesuara të komunitetit, si banorë, pronarë banesash, qeraxhi, pronarë biznesesh, të rinjë, mësues, mjek, persona të profesioneve të ndryshme, si dhe përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse apo jo-qeveritare me aktivitet dhe adresë në territorin e juridiksionit të Këshillit Komunitar.
 - c. Iniciativa, përfshin minimalisht informacionin dhe dokumentet e mëposhtme:
 - i. Emri i strukturës komunitare që propozohet të ngrihet.
 - ii. Emri i lagjes, apo të zonave për të cilën propozohet ngritja e strukturës komunitare.
 - iii. Harta dhe përshkrimi i kufijve të strukturës komunitare, dhe një shpjegim për arsyet e përcaktimit të kufijve të propozuar, përfshirë numrin e banorë, institucionet të varësi të bashkisë që ndodhen brenda territorit të propozuar, aspektet historike dhe identitetin e zonës, hapsirat publike të

- përfshira, tiparet gjeografike të territorit etj. Territori i Këshillit Komunitar të propozuar duhet të jetë mbrenda territorit të bashkisë.
- iv. Numri i zonave gjeografike brenda territorit të strukturës komunitare që propozohen.
 - v. Numri i anëtarëve të Këshillit Komunitar për secilën prej kategorive të palëve të interesuara (**neni 16 të kësaj rregulloreje**) të ndarë për secilën zonë të territorit të strukturës komunitare (pika iv e këtij neni).
 - vi. Të dhëna që provojnë se parashtruesit e iniciativës e kanë bërë publike iniciativën, përfshirë datat dhe vendet publike (sëpaku në tre vende) të lagjes apo të zonave ku kërkohet ngritja e Këshillit Komunitar.
 - vii. Emri, mbiemri, numri personal i identifikimit dhe të dhënat e kontakteve të parashtruesve të iniciativës.
 - viii. Shkresa e shprehjes së interesit të nënshkruar nga parashtruesit e iniciativës dhe që përbën aplikimin për çertifikimin e iniciativës.
 - ix. Vendi i propozuar për zhvillimin e aktivitetit të Këshillit Komunitar, nëse një vend i tillë është identifikuar nga parashtruesit e iniciativës.
 - x. Deklarimi në tekstin e iniciativës se anëtarësia në Këshillin Komunitar dhe e drejta e votimit për Këshillin Komunitar është e hapur për të gjithë palët e interesuara të komunitetit brenda kufijve të strukturës komunitare.
 - xi. Lista me nënshkrimet e mbështetësve të iniciativës.
2. Kushtet e certifikimit bëhen publike në faqen e internetit të Bashkisë.

Neni 33

Parashtruesit e aplikimit

1. Peticioni për aplikim për certifikimin e iniciativës qytetare përgatitet dhe nënshkruhet nga sëpaku pesë (5) parashtrues, të cilët duhet të përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi në lagjen apo zonat ky propozohet të ngrihet Këshilli Komunitar.
2. Parashtruesit janë votues të bashkisë dhe duhet të jenë:
 - a. banorë të lagjes,
 - b. përfaqësues të autorizuar të një shoqatë jo-fitimprurëse, shoqate biznesi, me kusht që aktiviteti i organizatës të zhvillohet në mënyrë përkohshme apo të përhershme brenda territorit të Bashkisë dhe të kenë adresën në territorin e bashkisë kjo më pak se një vit nga data e regjistrimit në bashki të aplikimit për ngritjen e structures komunitare,
 - c. një bashkim i personave të përmendur në pikat a dhe b më sipër.
3. Secili prej parashtruesve duhet të paraqesë në dokumentin e aplikimit emrin, atësinë dhe mbiemrin, datëlindjen, adresën e banesës apo organizatës, email dhe numrin e celularit, emrin e plotë të organizatës ku është anëtar (nëse nënshkruan në emër të organizatës), kopje të dokumentit personal të identifikimit, si dhe deklarin se është banor i lagjes apo dokumentin e autorizimit për të përfaqësuar organizatën në nënshkrimin e iniciativës qytetare.
4. Parashtruesit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes, nënshkrimit dhe paraqitjes së iniciativës qytetare pranë Këshillit Bashkiak.

5. Parashtruesit dhe nënshkruesit e petitionit nuk mund të jenë deputetë, persona që mbajnë pozicionin e të zgjedhurit vendor në Bashki, kryetar e zëvendëskryetar i bashkisë, sekretar i këshillit bashkiak, nëpunës civil të administratës së bashkisë, titullarë të institucioneve dhe drejtues të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë, prefekti i qakut, kryetari i këshillit të qarkut, ministra, zëvendësministra, drejtues të agjencive qeveritare qendrore në nivel qarku, drejtues të institucioneve shtetërore kombëtare.
6. Nuk mund të jenë parashtrues të një peticioni drejtuar Këshillit Bashkiak personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin, kushërinjë të parë, dajallarë e xhaxhallarë me nipa dhe mbesa, halla e teze me nipër e mbesa, bashkëpronarë të një biznesi.
7. Nëse aplikimi nuk përcakton qartë se kush janë parashtruesit, Këshilli nuk do ta shqyrtojë petitionin.

Neni 34

Bordi i certifikimit

1. Për certifikimin e iniciativave për ngritjen e Këshillave Komunitarë, Këshilli Bashkiak ngren Bordin e Certifikimit.
2. **Bordi përbëhet nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët tre (3) anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe dy (2) anëtarë nga administrata e bashkisë, dhe përkatësisht një anëtar i Komisionit të Përhershëm për Strukturat Komunitare dhe dy (2) këshilltarë të cilët përfaqësojnë dy grupet politike më të mëdha në Këshill,** si dhe drejtuesi i njësisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve dhe drejtuesi i drejtorisë apo sektorit juridike të Bashkisë. Anëtari i Komisionit për Strukturat Komunitare është kryetar i Bordit, ndërsa këshilltari që i përket opozitë është zëvendëskryetar i bordit. Këshillit Bashkiak mundëson respektimn e barazinë gjinore në përbërjen e anëtarësisë së Bordit.
3. Bordi shqyrton iniciativën qytetare për ngritjen e Këshillit Komunitar dhe vlerëson nëse iniciativa është paraqitur sipas kërkesave dhe plotëson kushtet e vendosura nga Këshilli Bashkiak.
4. Bordi i paraqet Këshillit propozimet për miratimin e iniciativës dhe ngritjen e Këshillit. Propozimi shqyrtohet paraprakisht nga Komisioni i Përhershëm i Strukturave Komunitare.
5. Të gjitha mbledhjet dhe dokumentacioni i mbledhjes së Bordit janë të hapura për publikun. Bordi fton në mbledhjet e tij administratorët e NjA të bashkisë, në varësi të çështjeve apo strukturave komunitare në territorin e NjA, si dhe ndërlidhësit komunitarë në detyrë për marrë pjesë në dëgjesa publike apo për të dëshmuar në lidhje me iniciativat e paraqitura për certifikim.
6. Rregullat e mbledhjes së Këshilli Bashkiak do të shërbejnë si udhëzuese për mbledhjet e Bordit. Mbledhja e radhës të Bordit thirret nga Kryetari i Bordit, dhe në mungesë dhe me autorizim me shkrim, nga zëvendëskryetari i Bordit. Mbledhjet u njoftohen anëtarëve nga Kryetari i Bordit, apo në mungesë nga zëvendëskryetari i Bordit, jo më vonë se pesë **(5) ditë pune** nga data e mbajtjes së mbledhjes. Mbledhja e Bordit dokumentohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga **Sekretari i Këshillit Bashkiak** apo një prej punonjësve të sekretariatit të Këshillit Bashkiak. Bordi harton raportin vjetor të

veprimtarisë së tij, i cili nënshkruhet nga Kryetari Bordit dhe paraqitet në Mbledhjen e Këshillit.

7. Bordi mund të mbajë takime të hapura apo dëgjesa publike me komunitetin, nëse e sheh të nevojshme për të marrë komente, propozime, informacione apo dëshmi në lidhje me iniciativën qytetare të paraqitur. Bordi përdor rregullat e Këshillit Bashkiak për komunikimin me publikun dhe mbajtjen e takimeve apo dëgjesave publike.
8. Vendimet e Bordit merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
9. Bordi pranon, shqyrton dhe kthen përgjigje për kërkesat apo ankesat drejtuar Bordit që lidhen me vendimmarrjen e Bordi, dhe në çdo rast Bordi kthen përgjigje brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e kërkesës apo ankesës.

Neni 35

Procesi i certifikimit

1. Të gjitha aplikimet për certifikimi e iniciativës për ngritjen e një Këshilli i drejtohen Këshillit Bashkiak dhe regjistrohen në zyrën e protokollit të Bashkisë.
2. Sekretari i Këshillit ia përcjell aplikimin Njesisë, për të bërë vlerësimin paraprak nëse iniciativa plotëson kushtet formale të përcaktuara nga kjo rregullore (neni 32 më sipër), dhe kërkon opinion me shkrim për plotësimin apo jo të këtyre kushteve.
3. Nëse Njësia vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së iniciativës, dhe nëse vëren se territori i këshillit komunitar të propozuar ka mbivendosje me territorin e një apo me shumë këshillave komunitarë, i dërgon parashtuesit kryesor të iniciativës kërkesën për plotësimin apo saktësimin e dokumenteve të kërkuara, dhe njofton njëherazi për këtë edhe Sekretarin e Këshillit.
4. Nëse Njësia vlerëson se iniciativa është paraqitur sipas kërkesave dhe kushteve të kësaj rregullore, dhe nëse është paraqitur vetëm një iniciativë për ngritjen e Këshillit Komunitar brenda kufijve të një lagje apo të disa zonave, Njësia e dërgon peticionin tek drejtoria apo sektori juridik i Bashkisë për vlerësim të përpushmërisë juridike të përmbajtjes së aplikimit. Mbas marrjes së miratimit me shkrim nga drejtoria apo sektori juridik, Njësia ia përcjell aplikimin Sekretari të Këshillit, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e marrjes së aplikimit, me konfirmimin se aplikimi plotëson kushtet për t'u shpërndarë për nënshkrime.
5. Nëse brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditore Njësia merr dy ose më shumë iniciativa për ngritjen e një Këshillit Komunitar në të njëjtin territor të lagjes apo të zonave, Njësia kontakton me të gjithë aplikuesit dhe i fton të bien dakort për të paraqitjen një aplikimi të përbashkët. Aplikantët do të kenë njëzet (20) ditë nga data kur u është bërë njoftimi për të rënë dakort dhe për të paraqitur një aplikim të përbashkët. Nëse konsensusi nuk arrihet brenda kësaj periudhe njëzet (20) ditore, atëherë të gjithë aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Njësia dhe drejtoria apo sektori juridik, dhe nëse ato i plotësojnë kushtet, i përcillen Sekretarit të Këshillit.
6. Nëse Njësia nuk arrin të vlerësojë aplikimin/et brenda periudhës prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, apo brenda periudhës shtesë prej njëzet (20) ditësh, kur ka më shumë se një aplikim, Njësia ia përcjell aplikimin/et menjëherë dhe pa opinion Sekretarit të Këshillit Bashkiak.

7. Me marrjen e shkresës nga Njësia, Sekretari i Këshillit miraton kalimin e aplikimit për nënshkrime, jo më vonë se pesë ditë (5) ditë nga data e marrjes së përgjigjes nga Njësia, dhe njofton për këtë me shkresë aplikuesin/t, dhe njëkohësisht njofton Kryetarin e Këshillit Bashkiak, Kryetarin e Bashkisë dhe Kryetarin e Bordit të Certifikimit.
8. Parashtuesit e aplikimit/eve kanë një afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e rregjistrimit në zyrën e protokollit të Bashkisë të njoftimit të Sekretarit të Këshillit për pranimin e aplikimit, për të mbledhur nënshkrimet. Nënshkrimet mblidhen sipas formatit të iniciativave qytetare, të miratuar nga rregullorja e Këshillit Bashkiak për petitionet dhe iniciativat qytetare. Nënshkrimet e regjistruara në zyrën e protokollit të Bashkisë, mbas përfundimit të afatit, nuk pranohen për shqyrtim nga Komisioni i Certifikimit. Nëse asnjë aplikues nuk ka regjistruar nënshkrimet brenda afatit, aplikuesi që do të regjistrojë dhe do të dërgojë pranë bashkisë i pari nënshkrimet, mbas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor, i pranohet aplikimi për tu shqyrtuar nga Komisioni i Certifikimit. Në çdo rast aplikimi nuk pranohet për shqyrtim nëse nënshkrimet regjistrohen me vonë se gjshtëdhjetë (60) ditë nga mbarimi i afatit tridhjetë (30) ditor.
9. Çdo ankesë e aplikuesve ndaj vlerësimit paraprak të njësisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve i drejtohet Komisionit të Certifikimit, i cili i kthen përgjigje aplikuesit brenda dhjetë (10) ditëve nga regjistrimi i ankesës në regjistrin e protokollit të Bashkisë.
10. Aplikantët janë përgjegjës për paraqitjen e të gjitha dokumenteve të kërkuara për të shqyrtuar dhe verifikuar përputhshmërinë e aplikimit me kërkesat dhe kushtet e kësaj rregulloreje.
11. Njësia për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve do t'u sigurojë parashtuesve të iniciativës qytetare të gjitha të dhënat e nevojshme për përgatitjen e aplikimit, përfshirë të dhënat për popullsinë e lagjes, zonave, hartat, përshkrimin e kufijve, formatet e dokumenteve që duhet të paraqesin, dhe dokumente të tjera të nevojshme.
12. I gjithë komunikimi i aplikantit/ve në lidhje me dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për paraqitjen e aplikimit dhe shqyrtimin e përputhshmërinë së aplikimit me kushtet dhe kërkesat e kësaj rregulloreje do të bëhet me Njësinë.

Neni 36

Seancat dëgjimore për certifikimit e iniciativës

1. Bordi për Certifikimin organizon sëpaku një dëgjesë publike përpara shqyrtimit të iniciativës për ngritjen e Këshillit Komunitar. Njoftimi për dëgjesën publike përmban datën, vendin dhe orën e mbajtjes së dëgjesës, dhe i njoftohet parashtuesve të iniciativës dhe publikut së paku shtatë (7) ditë para së dëgjesës nepërmjet faqes së internetit të Bashkisë dhe afishimit në së paku dy ambjete publike në territorin ku kërkohet ngritja e këshillit komunitar.
2. Të gjitha dokumentet apo prezantimet që do të paraqiten parashtuesit e iniciativës i dërgohen me email Sekretarit të Këshillit Bashkiak dhe drejtuesit të Njësisë jo më vonë se pesë (5) ditë para datës së dëgjesës.
3. Kryetari i Komisionit të Certifikimit hap seancën e dëgjimore publike dhe deklaron titullin e iniciativës.
4. Drejtuesi i Njësisë paraqet raportin e tij në lidhje me aplikimin, dhe i përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit të Certifikimit.

5. Kryetari i Komisionit të Certifikimit fton njërin nga aplikantët të paraqesi iniciativën e tyre, dhe ndërkohë i kërkon aplikuesit të deklarojë nëse dosja e aplikimit është e plotë nga këndvështrimi i tij dhe nëse ka kundërshtime apo sqarime për të dhënat e përfshira në dosje nga Njësia. Prezantimi i aplikantit do të zgjasë jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) minuta, dhe më pas ai i përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit të Certifikimit, në lidhje me prezantimin e aplikantit apo raportin e Njesisë.
6. Kryetari i Komisionit të Certifikimit fton anëtarët e publikut të paraqesin argumentat e tyre për mbështetjen e iniciativës. Anëtarët e publikut që dëshirojnë t'i drejtohen Komisionit në mbështetje të aplikimit, kanë maksimumi pesë (5) minuta kohë, dhe e njëjta kohë është në dispozicion për të dëgjuar komente nga të anëtarëve të publikut që kundërshtojnë certifikimin e iniciativës, nëse ka komente të tilla.
7. Komisioni mund t'i kërkojë aplikuesit/ve plotësimin e dokumenteve, nëse është e nevojshme. Njoftimi zyrtar i vendimit të Komisionit për plotësimin e dokumenteve, u komunikohet me shkresë aplikuesve por jo më vonë **se pesë (5) ditë** pas dëgjësës publike që mban Komisioni.

Neni 37

Shqyrtimi i aplikimit për certifikim

1. Komisioni i Certifikimit shqyrton aplikimin/et për certifikimin e iniciativës/ve për ngritjen e Këshillit Komunitar mbas dëgjësës publike dhe plotësimin të dokumenteve nga aplikuesit (nëse kjo e fundit është kërkuar nga Komisioni), dhe **brenda njëzet (20) ditëve** nga data e marrjes së aplikimit nga Sekretari i Këshillit.
2. Kryetari i Komisionit të Certifikimit mund të kërkojë ndihmën e administratorit të njësisë administrative përkatëse apo të drejtorisë apo sektorit të regjistrimit të bizneseve dhe ojf-ve, për verifikimin e nënshkruesve të peticionit.
3. Komisioni i Certifikimit me shumicë të votave të anëtarëve të tij, i propozon Këshillit të Bashkisë aprovimin ose kundërshtimin e aplikimit të certifikimit të iniciativës për ngritjen e këshillit komunitar, në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore, dhe bazuar në të dhëna dhe dokumentet e paraqitura nga aplikuesi/it.
4. Vendimi i Komisionit të Certifikimit i **kalon për shqyrtim mbledhjes më të parë të radhës së Këshillit Bashkiak**. Këshilli dëgjon raportin dhe propozimin e Komisionit të Certifikimit, raportin dhe propozimin e Komisionit të përhershëm për Strukturat Komunitare, si dhe dëgjon për pesë (5) minuta komentet e aplikuesit dhe pesë (5) min komentet e personave që janë kundër aplikimit (nese ka).
5. Këshilli Bashkiak vendos për miratin ose mos miratimin, apo shtyrjen e miratimit të aplikimit për certifikim. Në rast shtyrjes së miratimit, Këshilli Bashkiak duhet të shprehet përfundimisht për miratimin apo refuzimin e aplikimit në mbledhjen më të parë të radhës. Në rast refuzimi aplikuesi mund t'i drejtohet gjykatës administrative.
6. Rishqyrtimi nga Këshilli Bashkiak i një vendimi për mos dhënie të certifikimit mund të bëhet jo më heret **se tre (3) muaj** nga marrja e vendimit, dhe kjo për shkak se veprimi i Këshillit Bashkiak ka qënë i keq informuar apo këshilluar, apo rrethanat ligjore kanë ndryshuar pas datës së vendimit të parë për mos dhënie të certifikimit.

Neni 38

Anullimi i certifikatës së Këshillit

1. Këshilli Bashkiak mund të anullojë certifikimin e një Këshilli Komunitar. Nisma për anulimin e certifikimit mund të bëhet nga Kryetari i Bashkisë dhe nga Komisioni i Këshillit Bashkiak për Strukturat Komunitare.
2. Këshilli Bashkiak mund të anullojë certifikimin e një Këshilli Komunitar bazuar në vlerësimin e fakteve që provojnë se Këshilli Komunitar ka dështuar në mënyrë të përsëritur në zbatimin e kërkesave të ligjit, kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të tjera të miratuara nga Këshilli Bashkiak.
3. Në konstatimin e fakteve Kryetari i Bashkisë apo Komisioni për Strukturat Komunitare marrin parasysh edhe raportin e vlerësimit të bërë nga njësia për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve.
4. Njësia publikon në faqen e internetit të Bashkisë dhe në sèpaku tre (3) mjedise publike, për një periudhë **njëzet (20)** ditore, propozimin për anulimin e certifikimit. Brenda kësaj periudhe Kryetari i Bashkisë apo Komisioni për Strukturat Komunitare organizon një dëgjësë publike për të marrë reagimet dhe komentet e publikut për propozimin.
5. Kryetari i Bashkisë apo Komisioni për Strukturat Komunitare, i propozon Këshillit Bashkiak anulimin e certifikimit, jo më vonë se **pesëmbëdhjetë (15)** ditë nga mbarimi i afatit **njëzet (20) ditor** të publikimit të propozimit të Kryetarit të Bashkisë. Kryetari Bashkisë apo Kryetari i Komisionit për Strukturat Komunitare, bashkëlidhur propozimit i dërgon Këshilli Bashkiak: 1) evidencën se kërkesa për anulimin e certifikimit është publikuar në faqen e internetit të Bashkisë dhe në sèpaku tre (3) mjedise publike, për një periudhë **njëzet (20)** ditore; 2) evidencë se Kryetari i Bashkisë ka mbajtur një dëgjësë publike.
6. Këshilli Bashkiak e shqyrton propozimin për anulimin e certifikimit, në mbledhjen me të parë mbas depozitimit të propozimit të Kryetarit të Bashkisë apo Komisionit për Strukturat Komunitare.
7. Këshilli Bashkiak mund të vendosë pranimin apo refuzimin e anulimit të certifikimit.
8. Vendimi i Këshillit Bashkiak për anulimin e certifikimit i njoftohet Këshillit Komunitar brenda **dhjetë (10)** ditëve nga marrja e vendimit dhe bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë. Autoriteti i Këshillit Komunitar pushon së ushtruarit në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit Bashkiak.

KAPITULLI IV

ZGJEDHJET E ORGANEVE TE STRUKTURAVE KOMUNITARE

KREU I

PËRGATITJA, ADMINISTRIMI, MBIKQYRJA E ZGJEDHJEVE

Neni 39

Komisioni për administrimin e zgjedhjeve

1. Komisionit për Administrimin e Zgjedhjeve për strukturat komunitare përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të cilët janë Sekretari i Këshillit Bashkiak, zëvendëskryetari i Bashkisë, drejtuesi i drejtorise/vektorit juridik, drejtuesi i njësisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, juristi i sekretariatit të Këshillit Bashkiak apo një jurist i pavarur i caktuar nga Këshili Bashkiak, dhe kryesohet nga Sekretari i Këshillit. Komisioni ndihmohet nga së paku një punonjës i sekretariatit të Këshillit Bashkiak, dhe në mungesë të tij, nga punonjës të administratës së Bashkisë të caktuar nga Kryetari i Bashkisë.
2. Komision mblidhet sa herë Këshilli miraton mbajtjen e zgjedhjeve për Kryesinë apo Këshillin, dhe funksionon nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit Bashkiak për mbajtjen e zgjedhjeve deri në shpalljes përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve për Kryesinë/të apo Këshillin/at përkatës.
3. Detyrat e Komisionit janë:
 - a. Organizon zgjedhjet për Kryesinë apo Këshillat.
 - b. Administron materialet zgjedhore.
 - c. Siguron përgatitjen e fletëve të votimit.
 - d. Mbikqyr procesin dhe afatet e shpalljes së listave të zgjedhësve në fshat/ra.
 - e. Shpall dhe publikon rezultatet paraprake dhe përfundimtare të zgjedhjeve.
 - f. Përzgjedh qëndrat e votimit, mbi bazë të propozimeve të administratorëve të NjA.
 - g. Jep udhëzime për problemet që kanë të bëjnë me ecurinë e procesit zgjedhor.
 - h. Administron kërkesat nga organizata jo qeveritare për monitorim të zgjedhjeve dhe sipas rastit certifikon monitoruesit e propozuar.
 - i. Shqyrton ankesat për parregullësi në listën e zgjedhësve në fshat/ra.
 - j. Shqyrton ankesat për parregullësi në procesin e votimit.

Neni 40

Komisioni qendror për monitorimin e zgjedhjeve

1. Procesi i zgjedhjes së Kryesive dhe Kryetarëve të Fshatrave³⁵ dhe i Këshillave dhe Ndërlidhësave Komunitarë mbikëqyret nga Këshilli Bashkiak.
2. Këshilli me vendim ngre Komisionin Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve të strukturave komunitare në nivel Bashkie. Komisioni ka pesë (5) anëtarë dhe përbëhet

³⁵ Ligji nr. 139/2015, neni 70/5.

nga: Kryetari i Këshillit apo i autorizuari prej tij, kryetari i komisionit për strukturat komunitare, një këshilltar nga opozita më e madhe në Këshillin Bashkiak, zëvendëskryetari i bashkisë dhe një nga administratorët e NjA të caktuar nga Kryetari i Bashkisë. Komisioni i paraqet Këshillit Bashkiak raportin e monitorimit të zgjedhjeve, jo më vonë së 10 apo 15 ditë nga përfundimi i zgjedhjeve në secilin fshat apo lagje.

3. Këshilli Bashkiak emeron për çdo fshat apo lagje një Komision Monitorimi në nivel fshati apo lagje të përbërë nga tre (3) antarë, nga të cilët dy (2) janë këshilltarë bashkiakë, që i përkasin grupeve të ndryshme politike në Këshill, dhe një punonjës i administratës së bashkisë i emëruar nga Kryetari i Bashkisë. Anëtarët e këshillit bashkiak që janë njëkohësisht edhe banorë të fshatit apo lagjes përkatëse, preferohen të jenë anëtarë të Komisionit të Monitorimit në atë fshat apo lagje.
4. Secili Komision Monitorimi në nivel fshati apo lagje harton një raport, sipas formatit të miratuar nga Këshilli, dhe brenda pesë (5) ditë pune nga përfundimi i zgjedhjeve, ia dërgon Komisionin Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve.
5. Komisionin Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve brenda dhjetë (10) ditë pune, nga marrja e raporteve nga komisioneve të monitorimit harton, diskuton dhe miraton raportin e monitorimit të zgjedhjeve, dhe ia dërgon Këshillit Bashkiak për shqyrtim. Formatin e raportit miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Neni 41

Komisioni i qendrës së votimit

1. Për çdo qendër votimi ngrihet komisioni i qendrës së votimit. Kandidatët për anëtarë të Kryesisë apo Këshillit nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të qendrës së votimit, por në çdo rast mund të jetë vëzhgues.
2. Komisioni i votimit përbëhet nga sëpaku tre (3) anëtarë: një punonjës i sekretariatit të Këshillit Bashkiak apo një banor i fshatit/ lagjes i caktuar nga Këshilli Bashkiak, administratori i NjA ku ndodhet fshati apo lagjia apo një punonjës i administratës së bashkisë i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, një anëtar i pavarur (p.sh, mësues apo drejtues i një institucioni arsimor në fshat apo lagje, apo një drejtues i një OJF-je, një jurist, një banorë me reputacion në lagje apo fshat, por që nuk është anëtar i Kryesisë apo Këshillit Komunitar në detyrë, dhe i cili caktohet nga Këshilli i Bashkisë.
3. Këshilli me vendim përcakton anëtarët e Komisionit të Votimit për çdo qendër votimi.

Neni 42

Përgatitja se zgjedhjeve të kryesisë apo këshillit

1. Këshilli Bashkiak mundëson një proces informimi për zgjedhjet për Kryesinë apo Këshillat Komunitarë. Këshilli Bashkiak njëzet (20) ditë pune përpara organizimit të zgjedhjeve për Kryesinë apo Këshillin, informon banorët e çdo fshati apo lagje për rolin, funksionet, organizimin dhe detyrat e të Kryetarit e Kryesisë së Fshatit apo Këshillit dhe Ndërlidhësi Komunitar. Ky proces informimi organizohet nga Sekretari i Këshillit në bashkëpunim me administratorët e NjA-ve, kryetarët e fshatrave në detyrë, Njësinë dhe koodinatorin e bashkisë për njoftimin dhe konsultimin publik. Informacioni publikohet në faqen e internetit të Bashkisë dhe përfshihet në fletëpalosje që prodhohen për këtë qëllim.

2. Këshilli Bashkiak me vendim përcakton datat dhe vendet ku do mbahen votimet, për secilin fshat apo lagje të qytetit.
3. Administrata e bashkisë përgatit listën e zgjedhësve për çdo fshat dhe e shpall dhjetë (10) ditë përpara datës së zgjedhjeve për secilën prej Kryesive të Fshatrave. Shpërndarja e listave të zgjedhësve të fshatit mundësohet nga administratorët e NjA-ve me ndihmën e kryetarëve në detyre të fshatit përkatës. Listat vendoset për çdo lagje të fshatit, në mjediset e qendrës së votimit.
4. Administrata e Bashkisë përgatit fletët e votimit me emrat e kandidatëve të çertifikuar dhe vulos fletët e votimit me vulën e Bashkisë. Bashkia mundëson përgatitjen e gjithë dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore, përfshirë kutitë e votimit, fletët e votimit, dokumentin e procesverbalit të mbledhjes, etj., dhe ia dorëzon me procesverbal Kryetarit të Komisionit për Administrimin e Zgjedhjeve.
5. Proçesi i votimit është i hapur dhe Sekretari i Këshillit njofton dhe fton mediat për pasqyrimin e procesit zgjedhor.
6. Policia bashkiake organizohet për të qënë prezente jashtë mjediseve ku kryhet votimit, gjatë procesit zgjedhor dhe hyn në qendrën e votimit vetëm me kërkesë të komisionit të votimit kur kërkohet ndërhyrje për ruajtjen e sigurisë dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Neni 43

Përzgjedhja e qendrave të votimit

1. Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve merr parasysh kriteret e mëposhtme për të përzgjedhur qendrat të votimit:
 - a. Hapësirë e mjaftueshme për të akomoduar regjistrimin dhe votimin e zgjedhësve.
 - b. Mjedise që mundësojnë qasjen e përsosur me aftësi të kufizuar.
 - c. Parkim i mjaftueshëm për votuesit.
 - d. Qasje në tualete për anëtarët e komisionit të votimit dhe të monitorimit.
 - e. Afërsia e qendrës së votimit me transportin publik.
 - f. Mjediset e qendrës së votimit të jenë në dispozicion për gjithë ditën e zgjedhjeve.
 - g. Vendndodhja e qendrës së votimit të jetë sa më neutrale për kandidatët.
2. Në përzgjedhjen e qendrave të votimit KAZ ka përparësi objektet në pronësi të Bashkisë.

Neni 44

Orari i votimit

1. Qendrat e votimit hapen në orën 9:00 dhe mbyllen në orën 18:00.
2. Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve ruan të drejtën të zgjasë orarin e votimit, nëse do të jetë e nevojshme.

KREU II

KANDIDATET PËR ANËTARË TË KRYESISË APO KËSHILLIT

Neni 45

Kriteret e kandidatit

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u pranuar në procesin janë:
 - a) Të jetë banor i lagjes apo fshatit në të cilën kërkon të zgjidhet, prej të paktën 5 vitesh.
 - b) Të jetë ketë mbushur moshën 18 vjeç në ditën e votimit.
 - c) Të ketë minimalisht arsim të mesëm apo arsim profesional të barazvlefshëm.
 - d) Të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar.
 - e) Të mos jetë i punësuar në administratën e Bashkisë ku është banor apo në drejtimin apo menaxhimin e lartë të institucioneve apo ndërmarrjeve në varësitë Bashkisë.
 - f) Të mos jetë në një proces gjyqësor si i akuzuar për një vepër të rëndë penale, sipas përcaktimeve të kodit penal.
2. Kriteret bëhen publike në faqen e internetit të Bashkisë dhe publikohen zyrat e secilës NjA të Bashkisë, së paku tre (3) muaj para datës së zgjedhjeve të përcaktuar me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Neni 46

Kufizimet për kandidim

1. Një person nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një Kryesie apo Këshilli.
2. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtës Kryesi apo Këshill personat e lidhur: bashkëshortë, bashkëjetues, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin, kushërinjë të parë, dajallarë e xhaxhallarë me nipa dhe mbesa, halla e teze me nipër e mbesa.
3. Nëse kandidatët fitues në një Kryesi apo Këshill kanë lidhje familiare, sipas pikës dy (2) të këtij neni, kandidati që ka marrë me shume vota merr mandatin, ndërkohë personi në lidhje familiare i hiqet mandati dhe vendin e zë kandidati i listës i cili ka marrë me shumë vota. Nëse të dy kandidatët fitues kanë të njëjtin numër votash, hidhet short nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, dhe fituesit i jepet mandati.
4. Personat në lidhje familiare, sipas pikës një (2) të këtij neni, nuk mund të jenë anëtarë të njëkohshëm të disa Kryesive apo Këshillave. Kandidati që ka marrë më shumë vota i jepet mandati, ndërsa familiarit të tij i hiqet mandati dhe vendin e zë kandidati i listës i cili ka marrë me shumë vota. Nëse të dy kandidatët fitues kanë të njëjtin numër votash, hidhet short nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve, dhe fituesit i jepet mandati.
5. Nuk mund të jenë anëtarë të Kryesisë apo Këshill persona që mbajnë pozicionin e të zgjedhurit vendor në Bashki, zëvendëskryetar i bashkisë, sekretar i këshillit bashkiak, nëpunës civil të administratës së bashkisë, titullarë të institucioneve dhe drejtues të ndërmarrjeve në varësi të bashkisë, deputetë, prefekti i qakut, kryetari i këshilli të qarkut, ministra, zëvendësministra, drejtues të agjencie qeveritare qendrore në nivel qarku, drejtues të institucioneve shtetërore kombëtare.

Neni 47

Dokumenet e aplikimit që duhet të paraqesë kandidati

1. Çdo kandidat për anëtar të organit drejtues të Kryesisë së Fshati apo Këshillit Komunitar duhet të paraqesë një aplikim pranë Këshillit Bashkiak që përbëhet nga dokumentet ne vijim:
 - a. Një deklaratatë të nënshkruar, në formën e një letre angazhimit civil (modeli formati në shtojcën nr. 2) nëpërmjet të cilit kandidati shpreh angazhimin dhe qëllimet e tij për t'u përfshirë në strukturën komunitare dhe për të kontribuar për komunitetin në mënyrë vullnetare. Në këtë dokument citohet emri, atësia, mbiemri, datëlindja, numri i celularit, adresa e email dhe adresa e banesës së përhershme. Në deklaratatë kandidati duhet të deklarojë: a) fshatin dhe lagjen e fshatit apo lagjen e qytetit dhe zonën e lagjes së këshillit komunitar ku do të kandidojë; b) se nuk është i punësuar në administratën e Bashkisë apo në pozicione drejtimin apo menaxhimin e lartë të institucioneve apo ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë, ku është banor; c) se nuk është i shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar; ç) se nuk është në një proces gjyqësor si i akuzuar për një veprë të rëndë penale, sipas përcaktimeve të kodit penal.
 - b. Një kopje të dokumentit të identifikimit.
 - c. Dy fotografi të njëjta në formatin e fotografisë së pasaportës.
 - d. Një kopjen e notrizar të dokumentit që provon nivelin e arsimimit.
2. Deklarata dhe dokumentet që kërkohen sipas këtij neni dorëzohen njëherazi dhe dorazi nga kandidati në zyrën e protokollit apo zyrën me një ndalesë (ZIN) të bashkisë, apo dërgohen me postë në adresën e bashkisë, dhe i drejtohen Sekretarit të Këshillit.
3. Deklarata e kandidatit, që i është dërguar Bashkisë, është dokument publik.
4. Periudha e paraqitjes së deklaratës dhe dokumenteve nga kandidati do të fillojë gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve dhe do të zgjasë tridhjetë (30) ditë. Kandidatët që vendosin të tërheqin emrin e tyre nga fletëvotimi, duhet ta bëjnë këtë me shkrim ose me email, jo më vonë se njëzet e pesë (25) ditë para ditës së zgjedhjeve.
5. Deklarata dhe fotografia e kandidatit të certifikuar do të shfaqen në faqen e internetit të Bashkisë, tek nënfaqja Strukturat Komunitare. Nëse një kandidat tërhiqet, emri, deklarata dhe fotografia e kandidatit do të hiqen nga faqja e internetit e Bashkisë.
6. Të gjithë kandidatët do të pajisen nga bashkia me udhëzimet përkatës për procesin zgjedhor, të cilat gjithashtu do të publikohen në faqen e internetit të bashkisë.
7. Kandidati është përgjegjës për të identifikuar lagjen e fshatit apo zonën e lagjes së qytetit ku do të kandidojë, si dhe për t'u informuar për aktet nënligjore dhe rregulloret që rregullojnë procesin e para, gjatë dhe pas votimit.

Neni 48

Formulari i kandidatit për anëtar të këshillit komunitar

1. Çdo kandidat për anëtar të këshillit komunitar duhet të paraqesë një formular të plotësuar me informacionin si më poshtë:

- a. Emrin, atësinë, mbiemrin.
 - b. Datën e lindjes.
 - c. Numrin e telefonit.
 - d. Adresën e postës elektronike.
 - e. Adresën e plotë të banesës së përhershme.
 - f. Emrin dhe zonën e Këshillit Komunitar ku do të kandidojë.
 - g. Emrin e kategorisë për të cilin do të kandidojë (i. banorë apo qeraxhi; ii. pronarë biznesi; iii. përfaqësues i grupeve të interesit komunitar, iv. të rinjë).
2. Të dhënat e këtij formulari janë publike dhe do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë.
 3. Kandidati duhet ta paraqesë këtë formular bashkë me deklaratën e angazhimit të cituar në neni 47 më sipër.

Neni 49

Certifikimi i kandidatëve për kryesinë apo këshillin

1. Sekretari i Këshillit i dërgon Njesisë të gjithë dokumentacioni e dërguar nga personat që kanë bërë kërkesë për tu pranuar kandidatë për zgjedhjet për Kryesinë apo Këshillin.
2. Njësia bën vlerësimin e përmbushjes së kriterëve dhe kërkesave nga secili kandidat dhe raportin e vlerësimit të firmosur nga drejtuesi i Njesisë ia dërgon Komisionit për Strukturat Komunitare, brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e dokumentacionit nga Sekretari i Këshillit. Në procesin e vlerësimit Njësia bashkëpunon dhe këshillohet edhe me drejtoritë apo sektorët e tjerë të bashkisë.
3. Njësi ka të drejtë t'i kthejë dokumentacionin për korrigjim kandidatëve, nëse vëren se dokumentacioni i paraqitur ka parregullsi apo mospërmbushje të kriterëve dhe kërkesat e kësaj rregulloreje Njësi pranon depozitim të dokumenteve të korrigjuar jo me vonë se dhjetë (10) ditë nga dërgimi tek kandidati i kërkesës për korrigjim.
4. Komisionit për Strukturat Komunitare shqyrton raportin e vlerësimit të dërguar nga Njësia dhe shprehet me vendim për listën e kandidatëve të certifikuar. Komisionit për Strukturat Komunitare ka të drejtë ti kërkojë Njesisë verifikime shtesë për kandidatë që Komisioni e gjykon të arsyeshme.
5. Lista me kandidatët e certifikuar i njoftohet Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë, dhe i përcillet Sekretarit të Këshillit për njoftim publik në faqen e internetit të bashkisë dhe në tabelat e njoftimit publik.
6. Sekretari i Këshillit do të publikojë listën e kandidatëve të certifikuar njëzet (20) ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 50

Kundërshtimi i kandidatit

1. Çdo banor i lagjes apo fshatit, një organizatë komunitare, një organizatë jo-qeveritar apo fetare, që ka zyrat apo zbaton programe në vazhdimësi në territorin e lagjes apo fshati ka të drejtë të kundërshtojë kandidimin e një kandidati për anëtar të Kryesisë apo Këshillit.

2. Kundështimi paraqitet me shkrim tek Komisionit për Strukturat Komunitare, së paku pesë (5) ditë mbas shpalljes së listës së kandidatëve të certifikuar në faqen e internetit të bashkisë, tek ndërfaqja për strukturat komunitare.
3. Për t'u pranuar, kërkesa për kundështimin e kandidatit duhet të shoqërohen me informacionin e mëposhtëm:
 - a. Emri e Mbiemri, numri i telefonit, email të kundërshtuesit,
 - b. Një arsyetim për kundërshtimit të kandidatit,
 - c. Dokumentacioni që mbështet pretendimin e kundërshtimit.
4. Komisioni i përgjigjet kërkesë jo më vonë se pesë (5) ditë nga regjistrimi i kërkesë në zyrën e protokollit të Bashkisë.
5. Emri i kundërshtuesit dhe arsyetimi i paraqitur prej tij janë të dhëna publike dhe mund të publikohen në faqen e internetit të bashkisë.

Neni 51

Fushata zgjedhore e kandidatëve të certifikuar

1. Kandidatët e certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje për Kryesinë apo Këshillin kanë të drejtë të bëjnë fushatë nga data e shpalljes publike të listës së kandidatëve deri në 24 orë para orarit të fillimit të votimit.
2. Shpenzimet për fushatën zgjedhore përballohen nga vetë kandidatët.
3. Kandidatët nuk kanë të drejtë të përdorin fondet, mjetet, logot apo materialet e bashkisë apo të strukturave komunitare në shërbim të fushatës së tyre zgjedhore.

KREU III

ZGJEDHJA E ANETAREVE TE KRYESISË SË FSHATIT

Neni 52

Mbajtja dhe vlefshmëria e zgjedhjeve të kryesive të fshatrave

1. Anëtarët e kryesisë zgjidhen nga banorët me të drejtë vote të fshatit dhe përbërja e Kryesisë duhet të respektojë ligjin për barazinë gjinore,³⁶ dhe të mundësojë përfaqësimin e shumëllojshëm të grupeve të interesit si dhe të minoriteteve, aty ku ka.
2. Zgjedhjen bëhen për çdo lagje të fshatit, dhe janë të vlefshme nëse në të gjitha lagjet e fshatit kanë votuar më shumë se gjysma e banorëve me të drejtë vote të fshatit.³⁷
3. Çdo lagje e fshatit ka një qendër votimi.
4. Zgjedhjet nuk mbahen njëherësh në të gjithë fshatrat, por sëpaku në shtatë (7) deri në dhjetë (10) grupe fshatrash njëherësh. Këshilli Bashkiak përcakton kalendarin e mbajtjes së zgjedhjeve për Kryesinë e Fshatit.

³⁶ Ligji nr. 139/2015, neni 70/1

³⁷ Ligji nr. 139/2015, neni 70/1

5. Nëse zgjedhjet për kryesinë e fshatit, në një apo disa fshatra, nuk janë të vlefshme, për arsye se numri i votuesve ka qënë më pak se shumica e numrit total të banorëve me të drejtë vote të regjistruar në zgjedhjet e fundit vendore, zgjedhjet për Kryesinë zhvillohen jo më vonë së një (1) vit nga data e mbajtjes së zgjedhjeve vendore. Nëse edhe në zgjedhjet e dyta për Kryesinë marrin pjesë më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote, zgjedhjet mbahet mbas një periudhe prej jo më pak së një (1) vit nga data e zgjedhjetve të dyta, dhe nëse edhe në zgjedhjet e tretë për Kryesinë marrin pjesë më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote, Këshilli Bashkiak mund të vendosë për një datë tjetër për zgjedhjet e kryesisë së fshatit, po jo më vonë së një vit nga data e mbarimit të mandatit të Këshillit Bashkiak.

Neni 53

Votimi për Kryesinë

1. Votimi për anëtarët e Kryesisë bëhet i fshehtë.
2. Komisioni i votimit verifikon identitetin e votuesive dhe e ballafaqon me listen e votuesve.
3. Çdo votues duhet të paraqesë para komisionit të votimit dokumentin personal të identifikimit apo certifikatën personale të gjendjes civile.
4. Para marrjes së fletës së votimi çdo votues duhet të firmosë në listën e votuesve.

Neni 54

Mbyllja e votimit

1. Qendrat e votimit mbyllën në orën e caktuar sipas kësaj rregullore. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, KQV-ja mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qënë në radhë në orën e mbylljes së votimit. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit
2. Nëse të gjithë zgjedhësit e listës votojnë përpara mbarimit të orarit të votimit, Komisioni vendos mbylljen e votimit para afatit, mbas votimit të zgjedhësit të fundit.
3. Vendimi për mbylljen e votimit dhe ora e saktë e mbylljes së tij shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët KQV-së dhe Grupi i Monitorit të Këshillit, dhe vëzhguesit e certifikuar që përfaqësojnë kandidatët apo jo.

Neni 55

Vlerësimi i votave, nxjerrja e rezultatit dhe shpallja e fituesve

1. Anëtarët e KQV bëjnë vlerësimin dhe numërimin e votave. Sekretari i KQV harton tabelën e rezultateve e cila firmoset nga të gjithë anëtarët i KQV dhe rezultati i votimi shpallet nga Kryetari i KQV, në prani të Grupi të Monitorimit të Këshillit, dhe vëzhguesve të certifikuar që përfaqësojnë kandidatët apo atyre të pavarur.

2. Fituesit paraprak shpallen kandidatët që marrin numrin më të madh të votave të vlefshme në lagjen e fshatit. Nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short. Shorti drejtohet nga Sekretari i KQV.
3. Nëse numri i votuesve në lagjen e fshatit nuk është më shumë gjysma e banorëve me të drejtë vote në lagjen e fshatit, votimi në atë lagje quhet i pavlefshëm dhe kjo shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjes.
4. Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve (KAZ) administron tabelën e rezultateve të të gjithë KQV të secilës lagje të fshatit, dhe harton tabelën përmbledhëse të votuesve për çdo fshat dhe në total për fshatin.
5. Nëse numri total i votuesve nuk është më shumë se gjysma e banorëve me të drejtë vote të fshatit, KAZ shpall të pavlefshme zgjedhjet në fshat.
6. Nëse numri total i votuesve është shumë se gjysma e banorëve me të drejtë vote në fshat, KAZ shpall zgjedhjet në fshat të vlefshme. Në këtë rast të gjithë kandidatët fitues në lagjet e fshatit ku kanë votuar më shumë gjysma e banorëve me të drejtë vote në lagje, dhe të cilën kanë marrë më shumë se gjysmën e votave të vlefshme, shpallen fitues. Ndërkohë, gjithë kandidatët fitues paraprakë në lagjet e fshatit ku numri i votuesve nuk qënë më shumë se gjysma e banorëve me të drejtë vote në listës së votuesve në atë lagje, nuk shpallen fitues.
7. Shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo lagje të fshati dhe për të gjithë fshatin, bëhet nga KAZ jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e zgjedhjeve.
8. Vendimet e KAZ i dërgohen Këshillit Bashkiak, dhe në kopje e tyre i dërgohet Kryetarit të Bashkisë.

Neni 56

Dokumentimi i procesit të votimit

1. KQV mban Libri i Protokollit të Mbledhjes për dokumentimin e procesit të votimit.
2. Në këtë procesverbal Sekretari i KQV shënon minimalisht datën e fillimi dhe mbylljes së votimit; numrin personave që kanë votuar në qendrën e votimit; numrin e fletëve të votim të marra në dorëzim dhe numrin e fletëve të votimit të papërdorura, numrin e fletëve të votimit të demtuara; vendimet e marra nga KQV gjatë ditës së votimit, votat e marrë nga secili kandidat, emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatit apoëve fitues; vërejtjet e anëtarëve të KQV; problemet e ndodhura dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të votimit.
3. Libri i Protokollit të Mbledhjes firmoset nga tre (3) anëtarët e KQV.
4. Listat e zgjedhësve me nënshkrimet e votuesve, kutitë e votimit, fletët e votimit, procesverbali i votuesve pjesëmarrës, librin e protokollit të mbledhjes, i dorëzohen me procesverbal kryetarit të KAZ, dhe administrohen dhe ruhen nga Bashkia.

Neni 57

Ankesat për Procesin e Votimit

1. Ankesat për procesin e votimit paraqiten tek KAZ brenda pesë (5) ditë pune nga data e përfundimit të zgjedhjeve. Ankuesi duhet të sjellë edhe evidenca apo dokumentacione

për të provuar bazueshmerinë e ankesës. KAZ shprehet për pranimin apo refuzimin e ankesës, brenda pesë (5) ditë pune nga rregjistrimi i kërkesës në zyrën e protokollit të bashkisë.

2. Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen e KAZ, mund t'ia drejtojë ankesën Këshillit Bashkiak, e nësë edhe me përgjigjen e Këshillit Bashkiak nuk është i kënaqur mund t'i drejtohet gjykatës administrative të rrethit gjygsor.

KREU IV

ZGJEDHJA E ANETAREVE TE KËSHILLAVE KOMUNITARE

Neni 58

Votuesit për zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Komunitar

1. Votuesit që votojnë për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Komunitar duhet të jetojnë, punojnë apo të kenë pronësi në territorin e lagjes, si dhe të kenë mbushur moshën 18 vjeç në datën e votimit. Votuesit
2. Votuesit duhet t'i përkasin këtyre kategorive: i) banorë të lagjes që zotërojnë apo jo një prone të paluajtshme në territorin e lagjes; ii) pronarë të bizneseve në lagje, iii) persona që janë anëtarë të një organizate komunitare, jo-fitmiprurëse, jo-qeveritare apo fetare, apo punonjës të institucioneve arsimore parauniversitare, të cilat kanë një adresë sëpaku për një periudhë një (1) vjeçare brenda kufijve të territorit të lagjes dhe ushtrojnë aktivitet të verifikueshëm dhe me përfitime direkte për komunitetin e lagjes.
3. Çdo zonë e lagjes duhet të zgjedhë së paku nga një (1) përfaqësues të secilës kategori në Këshillin Komunitar.

Neni 59

Mbajtja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet për anëtarë të Këshillave Komunitarë mbahen jo më vonë se katër (4) muaj nga data e vendimit të Këshillit Bashkiak për certifikimin e ngritjes së këshillit komunitar.
2. Zgjedhjet mbahen njëherazi në të gjithë territorin e certifikuar për ngritjen e Këshillit Komunitar.
3. Këshilli Bashkiak siguron që anëtarët e tij mbikqyrin procesin zgjedhor në të gjitha qendrat e votimit, sipas grupeve të këshilltarëve të përcaktuar në vendimin e Këshilli Bashkiak dhe përbërjes së cituar në neni 40 të kësaj rregulloreje.
4. Nëse për të gjitha vendet për anëtarë të Këshilli Komunitar, në secilën prej zonave të strukturës komunitare ka vetëm një kandidat të certifikuar, zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Komunitar nuk mbahen, dhe secili kandidat shpallet fitues në zonën përkatëse, nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve.
5. Nëse në një zonë të lagjes është certifikuar vetëm një kandidat, zgjedhjet në atë zonë nuk mbahen dhe kandidati shpallet fitues nga Komisioni për Administrimin e Zgjedhjeve.

Neni 60

Fleta e votimi

1. Fletët e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshilli Komunitar janë për katër kategoritë e kandidatëve:
 - a. Banorë që janë pronarë të pasurive të paluajjtshme apo qeraxhi,
 - b. Pronarë biznesesh dhe persona që punojnë në territorin e strukturës komunitare.
 - c. Përfaqësues të organizatave apo grupeve të tjera të interesit komunitar.
 - d. Të rinjë (nga moshë 18 - 25 vjeç)
2. Në fletën e votimi vendoset emri, atësia dhe mbiemri i kandidatit. Emrat e kandidatëve në fletën e votimit vendosen sipas rendit alfabetik.

Neni 61

Votimi për Këshillin

1. **Votimi për anëtarët e Këshillit Komunitar bëhet i fshehtë.**
2. Komisioni i votimit verifikon identitetin, adresën dhe statusin e votuesit.
3. Votuesi merr nga Komisioni i Votimiti, plotëson dhe nënshkruan dokumentin "vetë konfirmues", nëpërmjet të cilit konfirmon identitetin e tij dhe statusin e anëtarit të një prej katër **(4) kategorive të cituara në neni 60 më sipër.**
4. Çdo votues duhet të paraqesë para komisionit të votimit një nga dokumentet e mëposhtme para marrjes së fletës së votimit:
 - a. dokumentin personal të identifikimit, apo certifikatën personale të gjendjes civile.
 - b. dokumentin e lejes së ushtrimit të aktivitetit të biznesit ku paraqitet emri i votuesit.
 - c. dokumentin e titullit të pronësisë për banesën apo mjedisin e biznesit.
 - d. një dokument që citon adresën e plotë të banimit apo të biznesit, përfshirë dokumentin origjinal të faturës tatimore të energjisë elektrike, apo të faturës tatimore të ujësjellësit, apo dokumentin e taksave të bashkisë, apo një dokument që provon titullin e pronësisë së banesës apo të mjedisit të biznesit, dhe ku secili nga këto dokumente duhe të citojë emrin e votuesit.
 - e. dokument me fotografi nga institucioni arsimor, apo shkresë të nënshkruar nga drejtuesi i institucionit arsimor.
 - f. dokumentin e organizatës që autorizon votuesit të votojë për Këshillin Komunitar (në rast se person voton në emër të organizatës).
5. Pas verifikimit të votuesit dhe dorëzimit nga ana e tij e dokumentit "vetë konfirmues", Komisioni i dorëzon votuesit një **nga katër** tipet e fletës së votimit, sipas statusit të palës së interesuar **(neni 60).**
6. Komisioni i votimit ka të drejtë të fotokopjojë në qendrën e votimit, çdo dokument që i paraqitet nga votuesi.
7. **Çdo votues voton për kandidatët e njërës nga kater kategoritë, duke pëzgjedhur nga lista një kandidat.**
8. **Fletët e votimit hidhen në katër kuti të ndryshme.**

Neni 62

Vlerësimi i votave, nxjerrja e rezultatit dhe shpallja e fituesve

1. Anëtarët e KQV bëjnë vlerësimin dhe numërimin e votave. Sekretari i KQV harton tabelën e rezultateve e cila firmoset nga të gjithë anëtarët i KQV.
2. Tabelat e rezultateve të votimit dhe i gjithë dokumentacioni i votimit i dorëzohet me procesverbal kryetarit të KAZ.
3. KAZ harton tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe nxjerr rezultatit e votimit për çdo zonë dhe për të gjithë strukturën komunitare, në prani të dhe Grupi i Monitorimit të Këshillit dhe vëzhguesve të certifikuar që përfaqësojnë kandidatët, apo atyre të pavarur.
4. Në rastet e votat të barabarta mes dy a më shumë kandidatëve, fituesi caktohet me short. Shorti drejtohet nga kryetari i KAZ.
5. Shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe e fituesve bëhet nga KAZ jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e zgjedhjeve.
6. Vendimet e KAZ i dërgohen Këshillit Bashkiak, dhe në kopje e tyre i dërgohet Kryetarit të Bashkisë.

Neni 63

Dokumentimi i procesit të votimit dhe administrimi i materialeve zgjedhore

Dokumentimi i procesit të votimit dhe administrimi i materialeve zgjedhore bëhet sipas kreut për zgjedhjet e kryesive të fshatrave, të kësaj regullorjeje.

KREU V

ZGJEDHJA E DREJTUESVE TE STRUKTURAVE KOMUNITARE

Neni 64

Mbledhja e parë e këshillit apo kryesisë

1. Këshillit Bashkiak përcakton datat e mbajtjes së mbledhjes së parë të Kryesive dhe Këshillave, por jo më vonë se **tridhjetë (30) ditë nga shpallja përfundimtare e rezultatit të zgjedhjeve për Kryesinë/të apo Këshillin/at.**
2. Sekretari i Këshillit njofton publikisht datën e thirrjes dhe rendin e ditës së mbledhjeve të para të Këshillave apo Kryesive, jo më vonë **se tre (3) ditë pune** nga data e marrjes së vendimit të Këshillit Bashkiak. Publikimi i njoftimit bëhet në faqen e interneti të Bashkisë, në sëpaku një media vendore kryesore. Administratorët e NjA mundësojnë vendosjen e lajmërimit për mbajtjen e mbledhjes në sëpaku dy (2) zona të lagjes apo lagje të fshatit.
3. Mbajtja e mbledhjes bëhet jo më pak **se shtatë (7) ditë** nga data e njoftimit të mbledhjes.
4. Kryesimi dhe deklarimi i hapjes së mbledhjes së parë, deri në zgjedhjen e kryetarit të fshatit apo ndërlidhësit, të bëhet nga këshilltari bashkiak që është deleguar të përfaqësojë Këshillin në mbledhje.
5. Në mbledhjen e parë Kryesia apo Këshilli:

- a. Konfirmon mandatet e anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit.
 - b. Zgjedh Kryetarin e Fshatit apo Ndërlidhësin Komunitar.
 - c. Miraton rregulloren e funksionimit të Kryesisë apo Këshillit (model struktura në shtojcën nr. 3).
 - d. Miraton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes.
6. Procesverbali i mbledhjes së parë mbahet nga punonjësi i autorizuar i Bashkisë.
 7. Nëse mbledhja e parë konstituë e Kryesisë apo Këshillit nuk mbahet për mungesë të kuorumit të anëtarëve të zgjedhur, mbledhja e radhës thirret mbas tridhjetë (30) ditëve. Nëse dhe në datën kur thirret mbledhja e dytë konstituë e Kryesisë apo Këshillit, nuk sigurohet kuorumi, Komisioni për Strukturat Komunitare (apo Kryetari i Bashkisë) vendos emërimin e anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit egzistues deri në numrin e nevojshëm për plotësimin e kuorumit. Në këtë rast anëtarët e emëruar nuk mund të zgjidhen në pozicionin e Kryetarit të Fshatit apo Ndërlidhësit Komunitar. Mbledhja tjetër konstituë e Kryesisë apo Këshillit mbahet brenda dhjetë (10) ditëve nga emerimi i anëtarëve të rinj, dhe data, ora dhe vendi i mbajtje së mbledhjes bëhen publike.

Neni 65

Zgjedhja e kryetarit të fshatit dhe ndërlidhësit komunitar

1. Kryetari i fshatit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Kryesisë së Fshatit,³⁸ dhe Ndërlidhësit Komunitar zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Komunitar.³⁹
2. Këshilli apo Kryesia, në mbledhjen e tyre të parë, miraton ngritjen e komisionit të votimit për zgjedhjen e Ndërlidhësit apo Kryetarit të Fshatit. Komision përbëhet nga tre (3) anëtarë të Kryesisë apo Këshillit. Në rastin e Këshillit Komunitar, komision përbëhet nga tre (3) anëtarë, nga të cilët dy banorë dhe një përfaqësues të grupeve të interesit komunitar apo organizatave jo qeveritare.
3. Anëtarët e komisionit të votimit së bashku me personin që kryen detyrat e sekretariatit, përgatisin fletët e votimit me emrat e kandidatëve të propozuar nga anëtarët e Kryesisë apo Këshillit.
4. Komisioni i votimit përgatit raportin me rezultatet e votimit dhe ia përcjell kryesuesit të mbledhjesi cili shpall emrin e personit që votëbesohet si kryetar fshati apo ndërlidhës.
5. Votimi për Kryetarin apo Ndërlidhësin, bëhet i fshehtë, dhe fitues shpallet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave të vlefshme. Nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short. Shorti drejtohet nga drejtuesi i mbledhjes së parë të Këshillit Komunitar.

³⁸ Ligji nr. 139/2015, neni 70/3.

³⁹ Ligji nr. 139/2015, neni 68.

KAPITULLI IV

FUNKSIONIMI DHE NDERVEPRIMI I KRYESISË DHE KËSHILLIT

KREU I

MBLEDHJET E KRYESISË DHE KËSHILLIT

Neni 66

Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së kryesisë dhe këshillit

1. Mbledhje a Kryesisë apo Këshillit thirret nga Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi.
2. Njoftimi bëhet nga Kryetari apo Ndërmjetësi, dhe në mungesë nga anëtari i autorizuar prej tij.
3. Njoftimi për datën, vendin, orën si dhe rendi i ditës i mbledhjes së radhës së Kryesisë apo Këshillit i shpërndahet anëtarëve dhe lajmërohet publikisht jo më vonë së shtatë (7) ditë nga data e mbledhjes.
4. Mbledhjet jashtë radhe dhe mbledhjet emergjente mbahen me kërkesë të Kryetarit të Fshatit apo Ndërmjetësit, apo një e treta (1/3) e anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit. Njoftimi dhe rendi i ditës i mbledhjes jashtë radhe i shpërndahet anëtarëve Kryesisë apo Këshillit dhe lajmërohet publikisht jo më vonë së dy (2) ditë nga data e mbledhjes.
2. Lajmërimi i mbledhjeve të Kryesisë apo Këshillit bëhet nga Kryetari apo Ndërmjetësi në minimum dy (2) vende publike, një nga të cilat është në godinën e NjA në territorin e të cilës është fshati apo lagjia.
3. Banorët e lagjes apo fshatit, përmes një peticion të nënshkruar nga jo më pak së 200 apo 500 persona, mund të kërkojë mbajtjen e një mbledhje të Kryesisë apo Këshillit.

Neni 67

Rendi i ditës i mbledhjes

1. Rendi i ditës i mbledhjes së Kryesisë apo Këshillit propozohet nga Kryetari apo Ndërlidhësi dhe miratohet në mbledhjen e Kryesisë apo Këshillit.
2. Rendi i ditës i mbledhjes ka kryesisht këto pika:
 - a. Zbatimi i projekteve dhe marrëveshjeve të miratuara nga Kryesia apo Këshilli.
 - b. Shqyrtimi i çështje të rendit të ditës e parashtruara për vendimmarrje në mbledhje.
 - c. Çështje e kërkuara për shqyrtim nga Këshilli dhe Kryetari i Bashkisë.
 - d. Çështje e kërkuara për shqyrtim nga njësi për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve apo nga administrator i NjA përkatëse.
 - e. Marrja e informacionit mbi gjendjen e proceseve pjesëmarrëse, konsultimeve publike dhe nismat e qytetarëve në lagje apo fshat.
 - f. Dëgjesa publike për pikat e rendit të ditës.
 - g. Një seancë me pyetje, dëshmi, komente e hapur për banorët dhe palët e interesuara të lagjes apofshatit, ku banorët dhe palët e interesuara mund të bëhen pyetje për çdo çështje jashtë rendit të ditës që ka të bëjë me lagjen apo fshatin.

Neni 68

Mbajtja e mbledhjes

1. Mbledhjet e radhës mbahen jo më rrallë se një mbledhje në dy muaj, dhe mbahen në javën e fundit të muajit, përveç muajit gusht dhe dhjetor.
2. Të gjitha mbledhjet e Kryesisë apo Këshillit mbahen brenda territorit të fshatit apo lagjes, përveç se kur mungojnë mjediset apo gjendja e emergjencës civile nuk e lejon.
3. Mbledhjet nuk mbahen në ditë festash zyrtare dhe në ditën e zgjedhjeve politike, përveç se në rast të mbledhjes emergjente.
4. Mbledhja hapet nga Kryetari apo Kryesuesi i Mbledhjes në orën e caktuar në rendin e ditës.
5. Një mbledhje e Kryesisë apo Këshillit Komunitar është e vlefshme nëse shumica e gjithë anëtarëve janë të pranishëm në të njëjtën kohë dhe vend, për të dëgjuar, diskutuar dhe shqyrtuar çështje në interes të lagjes apo fshatit dhe brenda kompetencave të Kryesisë apo Këshillit.
6. Mbledhjet janë të hapura dhe publike, dhe përsa është e mundur transmetohen në faqen e internetit të Bashkisë, apo të strukturës komunitare, nëse kjo e fundit ka një të tillë.
7. Mbledhja nuk duhet të mbahet nëse nuk është njoftuar publikisht ora dhe vendi i ndryshuar i mbajtjes të kësaj mbledhjeje. Nëse Kryesia apo Këshilli mban një mbledhje në një orë dhe vend ndryshe nga ç'është njoftuar publikisht, vendimet e marra nga kjo mbledhje janë të pavlefshme.
8. Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi mund ta shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet e mungesës së kuorumit, kur rrethanat nuk e lejojnë vazhdimin normal të mbledhjes (konflikte, emergjencë natyrore apo tjetër), apo kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i të gjitha pikave të rendit të ditës. Vendimi për shtyrjen e mbledhjes pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes. Mbledhja vazhduese mbahet në vendin, ditën dhe orën e njoftuar publikisht.
9. Në mbledhjet e komisioneve të Kryesisë apo Këshillit, përsa është e mundur, zbatohen të njëjtat rregulla si në mbledhjet e Kryesisë apo Këshillit.
10. Anëtarët e publikut mund të regjistrojnë mbledhjen e Kryesisë apo Këshillit me mjete audio-video, me kusht që të mos pengojnë zhillimin normal të mbledhjes, dhe këtë duhet ta bëjnë nga vendi i dedikuar për publikun.
11. Për çdo paqartësi, në zhvillimin e mbledhjes, Kryetari apo Ndërmjetësi, i referohen rregullave të mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

Neni 69

Kuorumi

1. Kuorum për mbledhjet dhe veprimet e Kryesisë apo Këshillit përcaktohet në rregulloren e Kryesisë apo Këshillit (p.sh shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve).
2. Kuorumi deklarohet nga Kryetari apo Ndërlidhësi mbas hapjes së mbledhjes, dhe në vazhdimësi sipas kërkesës së anëtarëve.

3. Asnjë mbledhje zyrtare nuk duhet të mbahet dhe asnjë vendim apo veprim i Kryesisë apo Këshillit nuk mund të merret pa qënë i pranishëm kuorumi i anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit.

Neni 70

Procesverbali i mbledhjes

1. Mbledhjet e Kryesisë apo Këshillit dhe të komisioneve të tyre pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga një prej person i miratuar me vendim të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhjes.
2. Procesverbali firmoset nga kryesuesi i mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit dhe shpërndahet anëtarëve me email përpara mbledhjes së ardhshme.
3. Procesverbali i mbledhjes miratohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë apo Këshillit.
4. Procesverbali i mbledhjes është i hapur për inspektim të banorëve dhe palëve të interesuara të lagjes apofshatit.

Neni 71

Votimi në mbledhje

1. Marrja e çdo vendimi apo ndërmarrja e çdo veprimi nga ana Kryeisë apo Këshillit, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, bëhet me votim të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të Kryesisë apo Këshilli të pranishëm dhe që votojnë Pro, (duke mos përfshirë abstenimet), në një mbledhje në të cilën sigurohet kuorumi. Abstenimi nuk konsiderohet si votë dhe prandaj nuk ndikon në përcaktimin e rezultatit të votimit.
2. Anëtarët e Kryesisë apo Këshillit votojnë në mënyrë individuale dhe nuk mund ta delegojë të drejtën e votës. Votimi i anëtarit me telefon me video apo nëpërmjet video konferencës dhe i ndjekur nga të gjithë anëtarët njëkohësisht, nuk lejohet përveç në rastet e emergjencës civile, dhe sipas rregullave që përcaktohen në rregulloren e brendshme të Këshillit Bashkiak.
3. Anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe që nuk votojnë, pranojnë vendimin e shumicës.
4. Votimi në mbledhje e Kryesisë apo Këshillit bëhet i hapur. Votimi bëhet i veçantë për secilën çështje të rendit të ditës, dhe rezultatet e votimit deklarohen nga Kryetari apo Ndërmjetësi apo kryesuesi i mbledhjes, dhe regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 72

Pezullimi i përkohshëm nga mbledhja i anëtarit

1. Këshilli mund të ndër marrë veprime për të qortuar në mbledhje një anëtar të Kryesisë apo Këshillit për sjellje të pahijshme dhe ofenduese apo për veprimet e penguese të mbledhjes.
2. Nëse anëtari nuk i ndërpret veprimet penguese apo sjelljet e pahijshme dhe ofenduese, Kryesia apo Këshilli mund të marrë vendim për pezullimin e pjesëmarrjes së anëtarit në atë mbledhje.

3. Shqyrtimi i qortimit apo pezullimi përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes dhe miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 73

Rishqyrtimi i vendimit të kryesisë dhe këshillit

1. Kryesia dhe Këshilli mund të rishqyrtojë ose ndryshojë vendimin e tij përmes procesit të mëposhtëm.
 - a. Para se Kryesia dhe Këshilli të rishqyrtojë vendimin e tij, Kryesia apo Këshilli duhet të miratojë një mocion për rishqyrtim, dhe më pas mund ta rishqyrtojë dhe marrë vendim për çështjen.
 - b. Mocioni për rishqyrtim duhet të paraqitet dhe miratohen gjatë të njëjtës mbledhje ku është marrë fillimisht vendimi.
 - c. Mocion për rishqyrtim mund të propozohet vetëm nga anëtari i cili më parë ka votuar në favor të vendimit të marrë.

Neni 74

Përgjegjësitë dhe detyrat e kryesuesit të mbledhjes së Kryesisë apo Këshillit

1. Përgatit dhe drejton mbledhjen, përgatit rendin e ditës së mbledhjes dhe dërgon ftesat për prezantuesit.
2. Inkurajon pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve në debat.
3. Kujdeset që mbledhja të zhvillohet sipas radhës së çështjeve dhe kohës së përcaktuar në rendin e ditës.
4. Sjell çështjet e rendit të ditës në votim.
5. Sqaron vendimeve të marra nga Kryesia apo Këshilli në mbledhjen e Këshillit Bashkiak apo të Komisioni të Përhershëm përkatës, kur kjo i kërkohet nga Këshilli Bashkiak.
6. Ndjek zbatimin e vendimeve të marra nga Kryesia apo Këshilli, në bashkëpunim me administratorin e NjA përkatëse dhe menaxherët e Bashkisë.
7. Kujdeset për zbatimin i akteve nënligjore dhe procedurave të mbledhjes.

Neni 75

Shqyrtimi i ankesave

1. Çdo banor apo grup interesi në fshati apo lagjes që kundërshton një vendim, ose beson se është ndikuar negativisht nga një vendim i Kryesisë apo Këshillit, mund të paraqesë një ankesë me shkrim tek Kryetari apo Ndërlidhësi në lidhje me mos respektimin nga Kryesia apo Këshilli të kësaj rregullore apo rregullores së Kryesisë apo Këshillit.
2. Kryesia apo Këshilli do të marrë në shqyrtim dhe do të përgjegjëjet ankuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pune.
3. Në rast se një ankesë nuk mund të zgjidhet përmes procesit që administrohet nga Kryesia apo Këshilli, ankesa mund të përcillet fillimisht administratorit të NjA, e më pas ankuesi mund t'i drejtohet Këshilli Bashkiak.

KREU II

MARRËDHËNIET E KRYESIVE DHE KËSHILLAVE ME BASHKINE

Neni 76

Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak

1. Këshilli Bashkiak mbikëqyr veprimtarinë e Këshillave Komunitarë dhe Kryesive të Fshatrave.
2. Ndërlidhësi Komunitar apo Kryetari i Fshatit mund të thirret në Mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij, dhe ka të drejtë të shprehë mendimin e tij, të mbrojë vendimin e Kryesisë apo Këshillit, apo të bëjë propozime për çështje që janë të lidhura me lagjen apo fshatin përkatës.
3. Komisioni për Strukturat Komunitare organizon së paku një herë në vit seanca dëgjimore publike me drejtuesit e strukturave komunitare për të dëgjuar komente, propozime dhe reagime në lidhje me shqetësimet, çështjet dhe problemet me të cilat përballen strukturat komunitare dhe që duhet të adresohen nga Këshilli Bashkiak.
4. Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Ndërlidhësit dhe Këshillat Komunitarë, si dhe me Kryetarët dhe Kryesitë e Fshatrave koordinohen nga Sekretari i Këshillit Bashkiak.

Neni 77

Marrëdhëniet me Kryetarin e Bashkisë

1. Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi Komunitar merr pjesë në takimet e organizuara nga Kryetari i Bashkisë, ku ato janë të ftuar.
2. I paraqesin Kryetari i Bashkisë me shkrim komentet dhe rekomandimet e tyre në lidhje urdhërat dhe urdheresat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë të cilat kanë ndikim në punën e tyre dhe të Kryesisë apo Këshillit.
3. Këshillojnë Kryetarin e Bashkisë për veprime apo mosveprime në fshat apo lagje.
4. Prezanton për miratim në Bashki çdo projekt që zbatohet nga Kryesia apo Këshilli, me fonde nga jashtë Bashkisë, dhe përse kjo kërkohet nga ligjislacioni apo vendimet dhe rregulloret e Bashkisë.

Neni 78

Marrëdhëniet me drejtoritë apo sektorët e Bashkisë

1. Ndërlidhësi apo Kryetari të Fshatit komunikon në mënyrë të vazhdueshme dhe bashkëpunon me drejtoritë apo sektorët e Bashkisë për të gjitha çështjet që i ndikojnë fshatit apo lagjes.
2. Bashkëpunon me drejtoritë apo sektorët përkatës të Bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve të financuara apo bashkëfinancuara nga Bashkia nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Komuniteteve.
3. Komunikon me Njësinë për aspektë të funksionimit të Kryesisë apo Këshillit Komunitar.

4. Komunikon me drejtorinë e financës dhe buxhetit në Bashki për aspektet e mirë menaxhimit dhe raportimit financiar për projektet e zbatuara nga Kryesia apo Këshilli.

Neni 79

Marrëdhëniet me administratorin e NjA

1. Administratori i Njesisë Administrative mbështet dhe koordinon veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave, si dhe ndërlidhësve dhe këshillave komunitarë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të NjA-së.⁴⁰
2. Kryetari i Fshatit dhe Ndërlidhësi Komunitar bashkëpunon ngushtë me Administratorin e Njesisë Administrative në lidhje me kontrollin e territorit.
3. Gjatë punës për monitorimin e territorit Ndërlidhësit apo Kryetarit të Fshatit njofton Administratorin e NjA në lidhje me:
 - a. raste e hedhjes së mbetjeve nga banorë dhe biznese jashtë pikave të grumbullimit të mbetjeve.
 - b. dëmtimet e rrugëve, trotuareve, ndriçuesve publik, mungesat e pusetave, etj.
 - c. rastet e shpërthimit të tubacioneve të ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza në sipërfaqen e tokës.
 - d. dëmtimet e brigjeve të lumejve dhe përrejtjeve, që përbëjnë rrezik për banorët dhe bizneset.
 - e. hedhjen në territor të llumrave dhe solucioneve të lengshme, që përbëjnë rrezik për banorët dhe bizneset.
 - f. dëmtimet e strukturave ujëmbledhëse.
 - g. Prerjen dhe dëmtimin e pyjeve.
 - h. ndërtime pa leje në territor.
4. Kryetari i fshatit apo Ndërlidhësi njofton Administratorin nëse ka ankesa nga banorët dhe bizneset ndaj punimeve të entit investues të cila kanë shkatuar dëme të shëndetit, të pronave të banorëve dhe të bizneseve, apo për punime që kanë shkaktuar dëme të mjedise publike si pasojë e punimeve të pa parashikuara në projekt.
5. Të gjitha njoftimet e Kryetari apo Ndërlidhësi i drejton administratorit dokumentohen në raportin mujor që Kryetari apo Ndërlidhësi i paraqet Njesisë.

Neni 80

Marrëdhëniet me Policinë Bashkiake

1. Ndërlidhësi apo Kryetari i Fshatit është në komunikim me Policinë Bashkiake për çështje të sigurisë publike, kontrollit të territorit, dhe zbatimit të akteve të Bashkisë në territorin e lagjes apo fshatit.
2. Njofton punonjës in e policisë bashkiake që mbulon territorin e lagjes apo fshatit, në rastet kur:
 - a. Vëren se ka probleme me sigurinë publike.
 - b. Vëren se pengohet zbatimi i një vendimi apo investimi të Bashkisë.

⁴⁰ Ligji nr. 139/2015, neni 65/1; 66/f.

- c. Vëren dëmtimin apo e kryerjen e ndërtimeve pa leje në pronat publike të Bashkisë.
 - d. Vëren dëmtimin e zonave apo objekteve me rëndësi historike dhe arkeologjike.
 - e. Vëren bllokimin e rrugëve apo shesheve publike nga banorët.
1. Të gjitha njoftimet e Kryetari apo Ndërlidhësi i drejton policisë bashkiake dokumentohen në raportin mujor që Kryetari apo Ndërlidhësi i paraqet njësisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve.

Neni 81

Veprimet e ndërlidhësit apo kryetarit të fshatit në lidhje sigurinë publike

1. Në rastet e emergjence civile që vijnë nga bllokimi nga bora, përmbytjet, shkarjet e dheut, çarjet e digave të ujëmbledhësve, bllokimit të rrugëve nga çarjet e rrugëve, emergjenca shëndetësore apo epidemi nga sëmundje virale apo tjetër, Kryetari i Fshatit dhe Ndërlidhësi Komunitar informon **administratorin e NjA** dhe mobilizon burimet njerëzore dhe materiale në komunitet për përballimin e situatës.
2. Është pjesë e taskforcës të ngritur në fshat apo lagje për përballimin dhe rekuperimin mbas fatkeqësisë natyrore, shëndetësore apo tjetër.
3. Ndihmon në identifikimin e familjeve në nevojë për ndihma finaciare dhe materiale. Në bashkëpunim me administratorin dhe punonjës social të NjA, merr masa për ofrimin e asistencës në banesë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar, siç është rasti i familjeve apo individëve në nevojë, përfituesit e ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, personat të cilët përfitojnë pension pleqërie.
4. Ndihmon në shpërndarjen e ndihmave dhe produkteve, ushqimore dhe joushqimore, për komunitetin, në bashkëpunim edhe me shërbimin e vullnetarëve.
5. Ndihmojnë në organizimin dhe zbatimin e evakuimit të detyruar për popullsinë e rrezikuar, të gjendjes së karantinës për popullsinë ose subjektet e prekura, në organizimin e punës për kontrollit të njëanshëm ose në bashkëpunim me komunitetin të banesave dhe objekteve private të demtuara apo për gjetjen e të mbijetuarve dhe të viktimave të fatkeqësisë, në kryerjen e shërbimeve funerale në rast fatkeqësish, në organizimin e procesit të eliminimit dhe të groposjes së detyruar të kafshëve dhe të çdo materiali tjetër që përbën burim infeksioni, epidemie masive, ndotjeje masive.⁴¹

KREU III

KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI I KOMUNITETIT

Neni 82

Komunikimi me komunitetin

1. Kryetari apo Ndërmjetësi dhe anëtarët e Kryesisë apo Këshillit komunikojnë rregullisht me banorët dhe palët e interesit të komunitetit, si dhe sigurojnë që informacionet shpërndahet në mënyrë të barabartë dhe në kohën e duhur tëk të gjithë komuniteti.

⁴¹ Ligji nr. 45/2019, neni 42/2.

1. Kryesia apo Këshilli organizon dhe koordinon të paktën dy komunikime masive në vit, çdo 5- 6 muaj, përmes shpërndarjes të materialeve të shtypura, fletëpalosjeve, mesazhe me email tek grupet e interes dhe organizatat, takime derë më derë, njoftime në vendet publike, standat e informacionit, prezencë në median vendore të shkruar dhe audiovizive, deklaratat për shtyp, ngjarje të komunitetit, në mënyrë që të zgjerojë mundësinë e njerëzve për të marrë pjesë në aktivitetet dhe punët e strukturës komunitare.
2. Çdo strukturë komunitare ka faqen e saj të internetit më vete apo të hostuar në faqen e internetit të Bashkisë. Në rast se Kryesia apo Këshilli përdorin faqen e internetit të Bashkisë, të dhënat dhe informacioni i faqes mirëmbahet në bashkëpunim me Njësinë. Kryetari apo Ndërmjetësi i dërgon me email Njësisë të gjithë informacionin e kërkuar apo informacionin që Kryesia apo Këshilli ka interes të publikojë. Në çdo rast Njësia mban në faqen e internetit të Bashkisë informacionin dhe të dhënat bazë për çdo strukturë komunitare, si dhe lidhjet e faqes së internetit të tyre (nëse kanë).

Neni 83

E drejta e informimit dhe transparenca

1. Veprimtaria dhe dokumentacioni i Kryesisë apo Këshillit është i hapur për publikun.
2. Kryetari dhe Ndërmjetësi, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, duhet t'i përgjigjen çdo kërkesë për marrje të informacioni, të dhënë apo dokumenti që administrohet nga Kryesia apo Këshilli, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data dorëzimi i kërkesës pranë Kryesisë apo Këshillit.
3. Nëse të dhënat, informacionet apo dokumentet e kërkuara nuk i jepen kërkuarit, në shkresën e përgjigjes duket përcaktuar baza ligjore për mos dhënjen e tyre.

Neni 84

Mobilizimi dhe angazhimi i komunitetit

1. Kryesia apo Këshilli nxit dhe mobilizon banorët të marrin pjesë në takimet dhe konsultimet publike të organizuara nga Bashkia, në lidhje me buxhetin vjetor të Bashkisë, paketën fiskale, përcaktimin e prioritetit strategjik, planifikimin e zhvillimit të territorit, hartimin e planeve të shërbimeve publike, zbatimin e projekteve zhvilluese, shitjen apo dhënjen me qera të pronave bashkiake, zbatimin e projekteve dhe bërjen e investimeve me ndikim në mjedis, etj.
2. Kryesia apo Këshilli nxit dhe mobilizon banorët dhe grupet e interes komunitar për të ngritur fonde apo për të ofruar punë vullnetare në dobit të komunitetit.
3. Këshilli Komunitar organizon sëpaku një konsultim publik me komunitetin përpara se t'i paraqesë Këshillit Bashkiak propozimin që në një lagje të krijohen më shumë se një këshill komunitar apo për bashkimin e këshillit komunitar me atë të një lagje tjetër.
4. Kryesia apo Këshilli miraton planin vjetor të komunikimit dhe angazhimit të komunitetit në veprimtarinë dhe aktivitetet e strukturës komunitare.
5. Kryesia apo Këshilli nxit krijimin e grupit të vullnetarëve për t'u angazhuar në ndihmë të Kryesisë apo Këshillit për oraganizimin dhe mbështetjen e veprimtarive dhe aktiviteteve të strukturës komunitare.

KREU IV

VLERESIMI DHE LLOGARIDHENJA E STRUKTURAVE KOMUNITARE

Neni 85

Etika në punën e strukturave komunitare

1. Në ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të tyre anëtarët e Kryesisë dhe Këshillit duhet të përpiqen të përmbushin standardet më të larta të etikës.
2. Anëtarët do të respektojnë kodin e etikës të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Neni 86

Mbikqyrja dhe vlerësimi i Strukturave Komunitare

1. Administratorët e NjA-ve mbikëqyrin veprimtarinë e Kryetarëve e të Kryesive të Fshatrave, si dhe të Ndërlidhësve dhe Këshillave Komunitarë të strukturave komunitare që ndodhen në territorin e NjA-ve përkatëse,⁴² si dhe bëjnë raportime tre mujore, apo sipas kërkesës, pranë Njesisë për problemet që lidhen me veprimtarinë e strukturave komunitare.
2. Njësia bën vlerësimin dhe harton raportin vjetor për veprimtarinë dhe performancën e strukturave komunitare, mbi bazën e treguesve të performances të miratuara nga Këshilli Bashkiak, dhe propozon udhëzime apo rregullime për mirëfunksionimin e tyre. Raporti vjetor i paraqitet Këshillit të Bashkisë i cili e shqyrton brenda tre (3) mujorin e parë të vitit pasardhës.
3. Komisioni për Strukturat Komunitare shqyrton raportin vjetor të performancës së strukturave komunitare të hartuar nga Njësia, dhe i propozon Këshillit Bashkiak politika apo rregulla e norma për të përmirësuar veprimtarinë dhe për të fuqizuar strukturat komunitare.

Neni 87

Vetëvlerësimi dhe llogaridhënja e strukturave komunitare

1. Çdo Kryesi apo Këshill organizon një anketim me banorët, të paktën një herë në dy vjet, për të vlerësuar nëse Kryesia apo Këshilli ka përmbushur qëllimet e përcaktuara këtë rregullore apo në ndonjë dokument tjetër të politikave të Bashkisë për strukturat komunitare. Gjetjet e anketimit do të bëhen publike në faqen e internetit të Bashkisë.
2. Kryesia apo Këshilli organizon **brenda muajit Prill** të çdo viti takimin llogaridhënës me publikun, ku Kryetari apo Ndërlidhësi prezanton raportin vjetor të veprimtarisë së Kryesisë apo Këshillit, përfshirë mbështetjen buxhetore të përfituar për zbatimin e projekteve në fshat apo lagje. Takimi llogaridhënës i njoftohet publikut dhjetë (10) ditë para mbledhjes nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë dhe publikimit të njoftimit në shtëpaku tre mjedise publike në fshat apo lagje.
3. Njësia ndihmon Kryesitë apo Këshillat me procesin e anketimit dhe i siguron formatet e raportit të llogaridhënjes.

⁴² Ligji nr. 139/2015, neni 66/f.

KREU V

ADMINISTRIMI I MJETEVE DHE DOKUMENTEVE TE KRYESISE DHE KESHILLIT

Neni 88

Vula dhe stema e strukturave komunitare

1. Strukturat komunitare **kanë të drejtë** të kenë vulën e tyre, e cila mbahet dhe përdoret nga Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi.
2. Vula përdoret për vulosjen e vendimeve të Kryesisë apo Këshillit dhe të dokumentacionit që prodhohet nga veprimtaria e Kryesisë dhe Këshillit, apo Kryetari i Fshatit dhe Ndërlidhësi.
3. Kryetari i Fshatit pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga Bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin.⁴³
4. Strukturat komunitare mund të kenë stemën e vet të cilën e përdorin në të gjitha dokumentet që prodhojnë, korrespondencën dhe publikimet e tyre, si dhe në ngjarjet që organizojnë.
5. Për dëmtimin ose humbjen e vulës Kryetari apo Ndërlidhësi njofton menjëherë Këshillin dhe Kryeatrin e Bashkisë, dhe për këtë bën një deklaratë më shkrim.
6. Kryetari i Fshatit apo Ndërlidhësi në mungesë të zyrës dhe kasafortës duhet ta ruajë vulën në një vend të sigurt.

Neni 89

Administrimi dhe ruajtja e dokumentacionit të Kryesisë apo Këshillit

1. Librat e kontabilitetit, rregjistrat, procesverbalet, minutat e mbledhjeve dhe procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë apo Këshillit dhe të komisioneve të përhershme, dhe çdo dokument tjetër dhe prodhohet nga veprimtaria e Kryesisë apo Këshillit dhe Kryetarit të Fshatit apo Ndërmjetësi mbahen një vend të përcaktuara nga Kryesisë apo Këshilli.
2. Kryetari apo Ndërlidhësi kujdesen për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve të Kryesisë apo Këshillit sipas përcaktimeve në ligjin “Për arkivat”, sipas Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë si dhe sipas përcaktimeve në rregullores për arkivat të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
3. Kryetari i Fshatit apo Ndërmjetësi është përgjegjës për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit tek drejtuesi i sapozgjedhur i Kryesisë apo Këshillit, në fund të ushtrimit të mandatit të tij.

⁴³ Ligji nr. 139/2015, neni 71/4.

KREU VI

FORUMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE

Neni 90

Forumi i Ndërlidhësve Komunitarë dhe Krytarëve të Fshatrave

1. Në bashki ngrihet Forumi i Drejtuesve të Strukturave Komunitare, anëtarë të të cilit janë të gjithë ndërlidhësit komunitarë dhe kryetarët e fshatrave.
2. Forumi është organanim që diskuton çështjet dhe problemet e ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të strukturave komunare. Forumi vlerëson funksionimin e sistemit të strukturave komunare dhe i paraqet Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë propozimet për përmirësime legjislative, forcimin e kapacitetesve, mbështetjen financiare dhe aspekte të bashkëpunimit mes strukturave komunitare dhe Bashkisë.
3. Forumi shërben edhe si një platformë për të ndarë praktika, eskperienca, nevoja, sfida dhe inovacione.
4. Forumi zgjedh bordin drejtues të forumit, i cili për përbëhet nga pesë (5) anëtarë, tre (3) kryetarë fshatrash dhe dy (2) ndërlidhës komunitarë. Anëtarësia e bordit respekton kërkesat e ligjit për barazinë gjinore. Bordi zgjedh kryetarin e Forumit për një periudhë 2 vjeçare. Nëse për periudhën e parë dy (2) vjeçare kryetar forumi zgjidhet një kryetar fshati, në periudhën e dytë zgjidhet një ndërmjetës komunitar.
5. Forumi mblidhet një herë në dy vjet dhe Bashkia mbështet me logjistikë dhe fonde mbajtjen e mbledhjes së Forumit.
6. Forumi ka katër (4) komitete: Komiteti për funksionimin dhe rregullat e strukturave komunitare dhe financat; Komiteti për marrëdhënjet me Bashkinë; Komiteti për marrëdhënjet me komunitetin, performancën dhe llogaridhënjen; dhe Komiteti për kontrollin e territorit, shërbimet publike dhe projektet. Dy komitete drejtohen nga kryetarë fshati dhe dy komitete nga ndërmjetës. Anëtarësia e komiteteve është e përzier me kryetarë fshati dhe ndërlidhës komunitarë. Anëtarësia e komiteteve respekton kërkesat e ligjit për barazinë gjinore. Komitetet mblidhen çdo gjashtë muaj. Raportet gjashtë mujore të secilit komitet i paraqiten Bashkisë dhe mbledhjes vjetore të forumit.
7. Forumi mund t'i propozojë Këshillit Bashkiak rekomandime për ndryshime të kufijve të lagjeve dhe fshatrave.

Neni 91

Rregullorja e strukturës komunitare

1. Çdo Kryesi apo Këshill, bazuar në këtë rregullore, harton dhe miraton rregulloren e strukturës komunitare, ku detajon përgjegjësitë, detyrat, strukturën dhe procedurat e punës së Këshillit dhe Ndërmjetësit Komunitar apo Kryesisë dhe Kryetarit të Fshatit. Në çdo rast, rregullat shtesë nuk do të ndryshojnë ose zëvendësuar rregullat bazë të kësaj rregulloreve dhe të rregulloreve apo akteve të tjera të miratuara nga Këshilli Bashkiak.
2. Një kopje e projekt rregullores i dërgohet Njësisë, e cila në bashkëpunim me drejtorinë apo sektorin juridik të Bashkisë bën vlerësimin e secilës rregullore dhe i dërgon Kryesisë apo Këshillit përkatës përmirësimet e sugjeruara. Ndërmjetësi Komunitar apo Kryetari i

Fshatit bëjnë reflektimet e sugjerimeve dhe mbas mbajtjes së një seance konsultimi publik me komitetin e fshatit apo lagjes, e paraqet për miratim në mbledhjen e Kryesisë apo Këshillit. Kopja e miratuar e rregullores i dërgohet zyrtarisht Njesisë.

3. Nëse dispozitat e rregullores së miratuara nga Kryesia apo Këshilli bien ndesh me aktet nënligjore, këtë rregullore dhe rregulloret apo akteve të tjera të miratuara nga Këshilli Bashkiak, do të prevalojnë këta të fundi.
4. Rregullorja e strukturës komunitare mund të miratohen, ndryshohen ose shfuqizohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kryesisë apo Këshillit.

Neni 92

Përdorimi i rregullores së këshillit bashkiak

Për situatat ose rrethanat të cilat nuk janë parashikuar në këtë rregullore zbatohen dispozitat analoge të rregullores së brendshme të funksionimit të Këshillit Bashkiak.

Neni 93

Konsultimi publik i rregullores

Këshilli Bashkiak përpara miratimin të ndryshimeve të kësaj rregulloreje mban takime publike dhe seanca dëgjimore me publikun, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e Këshillit Bashkiak për pjesëmarrjen dhe konsultimet publike në qeverisjen bashkiake.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 94

1. Njësia për komunitetet bën një vlerësim të përputhshmërisë së ngritjes dhe funksionimit të strukturave aktuale komunitare, dhe identifikon mospërputhjet me kërkesat e kësaj rregullore. Raporti i përputhshmërisë paraqet në mbledhjes së Këshillit Bashkiak jo më vonë se dy muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
2. Ngarkohen Bashkia _____, Këshillat dhe Ndërlidhësit Komunitarë dhe Kryesitë dhe Kryetarët e Fshatrave për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. **Kjo rregullore miratohet me votimin Pro të shumicës së të gjithë anëtarëve të Këshillit të Bashkiak**
4. Kjo rregullore hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

SHTOJCAT

Shtojca nr. 1 Format aplikimi për certifikimit të iniciativës qytetare për ngritjen e strukturës komunitare.

INICIATIVE QYTETARE PER NGRITJEN E STRUKTURES KOMUNITARE

Drejtuar: Këshillit Bashkiak _____

Adresa: Tel: Cel: Email:

1. Ne, të nënshkruarit banorë të regjistruar të Bashkisë_____, të Qarkut_____, dhe banues në adresat e përcaktuara anash emrave tanë përkatës, me respekt kërkojmë:
2. Kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak është: Për ngritja e strukturës komunitare (emri) _____.
3. Titulli i projekt aktit: Ngritja e strukturës komunitare (emri)_____.
(Një kopje e plotë dhe e saktë e projekt aktit/vendimit i bashkëngjitet këtij Peticioni)
4. Baza ligjore të peticionit është neni 20 dhe 68/1 i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisje vendore”;
5. Emri i lagjes, apo të zonave për të cilën propozohet ngritja e strukturës komunitare.
6. Harta dhe përshkrimi i kufijve të lagjes apo të zonave për të cilën propozohet ngritja e Këshillit Komunitar.
7. Numrin e zonave gjeografike brenda territorit të strukturës komunitare që propozohen.
8. Numrin e anëtarëve të këshillit komunitar për secilën prej kategorive të palëve të interesuara të ndarë për secilën zonë të territorit të strukturës komunitare.
9. Situata/Çështja që nxiti dorëzimin e këtij peticioni është: _____
10. Parashtruesit e iniciativës janë:
 - 10.a) Emri____, Atësia____, Mbiemri____, ID __ (person kontakti), Firma____, Tel:____, Cel:____, Email:____.
 - 10.b) Emri____, Atësia____, Mbiemri____, ID____, Firma____, Tel:____, Cel:____, Email:____.
11. Afati i nënshkrimit të peticionit është data_____ ora_____.
12. Dokumentet shoqëruese të peticionet janë (nëse ka):
 - a) Harta e strukturës komunitare të propozuar, dhe e zonave brenda territorit të strukturës komunitare
 - b) Shpjegim për arsyet e përcaktimit të kufijve të strukturës komunitare të propozuar.

(faqja e dytë e çdo flete të peticionit)

13. Titulli i projekt aktit: Ngritja e strukturës komunitare (emri)_____
14. Unë i nënshkruari deklaroj në përgjegjësi time se informacioni që kam dhënë është i vërtetë dhe i saktë, dhe se nënshkrimi që kam bërë është autentik, dhe se unë ka mbështetur këtë peticion vetëm një herë.

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Adresa	Banor (B)/ Org (emri)	Firma	Data
1							
2							
20/50							

15. Numrin e identifikimit të peticionit _____.
16. Anëtarësia në këshillin komunitar dhe e drejta e votimit për këshillin komunitar është e hapur për të gjithë palët e interesuara të komunitetit brenda kufijve të strukturës komunitare.
17. Nënshkrimi i këtij peticioni është i hapur për të gjithë palët e interesuara në territorin e strukturës komunitare të propozuar.
18. Mbrojtja e të dhënave personale (citimi) _____.

Shtojca nr. 2: Model deklaratatë e angazhimit civil të kandidatit për anëtar të kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar.

DEKLARATATË

ANGAZHIMI CIVIL SI ANËTAR I KRYESISË SË FSHATIT APO KËSHILLI KOMUNITAR

Drejtuar: Këshillit Bashkiak _____

Unë i nënshkruari (emër, atësi, mbiemër) _____, i datëlindjes ____/____/____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale, se:

Shpreh vullnetin tim të plotë për t'u angazhuar dhe kontribuar vullnetarisht si anëtar i Kryesisë së Fshatit _____ apo Këshilli Komunitar _____, dhe për të kontribuar në fuqizimin dhe zhvillimin dhe rritjen e cilësisë së jetës së komunitetit të fshatit _____ apo lagjes _____, në rritje e pjesëmarrjes së komunitetit dhe palëve të interesuara në çështjet e qeverisjes vendore, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të lagjes apo fshatit.

Deklaroj gjithashtu se:

- nuk jam i punësuar në administratën e Bashkisë _____ apo në pozicione drejtimin, apo menaxhimin e lartë të institucioneve apo ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë _____,
- nuk jam i shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;
- nuk jam në një proces gjyqësor si i akuzuar për një vepër të rëndë penale, sipas përcaktimeve të kodit penal.**

(Nënshkrimi)

(Data)

Kontaktet:

Adresa.

Cel.

Email. _____

(shënim i bashkisë)

Dorëzuar pranë Bashkisë _____ me datë _____

Shtojca nr. 3: Model strukturë e rregullore së kryesisë së fshatit apo këshillit komunitar

I. Emri i Strukturës Komunitare

II. Qëllimi

III. Kufijtë

1. Përshkrimi i kufijve
2. Kufijtë e brendshëm të zonave të lagjeve apo lagjeve të fshatrave

IV. Palët e interesuara, banorët

V. Këshilli Komunitar apo Kryesia e Fshatit

1. Përbërja
2. Kuorumi
3. Veprimet që ndërmerren
4. Afati i mandatit të Këshilli Komunitar apo Kryesisë së Fshatit
5. Detyrat dhe fuqitë e Këshilli apo Kryesisë
6. Vende të lira
7. Mungesat e anëtarit
8. Pezullimi i anëtarit
9. Shkarkimi i anëtarit
10. Dorëheqja e anëtarit
11. Ndërveprimi me komunitetin

VI. Ekzekutivi i Strukturës Komunitare

1. Detyrat dhe fuqitë e Kryetarit të Fshatit apo Ndërlidhësit
2. Përzgjedhja e zyrtarëve
3. Afatet e punës së zyrtarëve

VII. Komitetet dhe Detyrat

1. Komitetet e përhershme
2. Krijimi i komiteteve
3. Detyrat e komiteteve

VIII Mbledhje e Këshillit

1. Koha dhe vendi i mbledhjes
2. Përcaktimi i rendit të ditës
3. Njoftimi i mbledhjes
4. Llojet e mbledhjeve
5. Rishqyrtimi e vendimeve të Këshillit apo Kryesisë

IX. Financat

1. Mbajtjave llogarive
2. Auditimi
3. Kontratat
4. Raportet financiare

X. Zgjedhjet

1. Administrimi i Zgjedhjeve
2. Struktura e Këshillit apo Kryesisë dhe Votimi
3. Moshë minimale e votimit
4. Metoda e verifikimit të statusit të palëve të interesuara (rasti i këshillit komunitar)
- 5.. Kufizime për kandidatët që kandidojnë për vende të shumëfishta

XI. Proçesi i ankesave

XII. Raportet

1. Vjetor
2. Periodik

XIII. Ndryshimet e Rregullores

XIV. Zbatimi i Rregullores, Akteve nënligjore

1. Trajnimet e detyruara
2. Vetëvlerësimi i strukturës komunitare

A - Harta e Këshillit Komunitar

Referencat:

1. Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 8548 datë 11.11.1999 “Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”.
3. Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 68 datë 27.04. 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.
5. Ligji nr. 44 datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.
6. Ligji nr. 8480 date 27.5.1999, “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.
7. Ligji nr. 115 datë 31.7.2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.
8. Ligji nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”.
10. Ligji nr. 146 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
11. Ligji nr. 152 datë 17.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”.
12. Ligji nr. 107 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
13. Ligji nr. 45 datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
14. Ligji nr. 9970 datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.
15. Ligji nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
16. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”, i ndryshuar
17. Ligjinr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”
18. Ligji nr. 10 296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
19. Ligji nr. 138 datë 17.12. 2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike”.
20. Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale“, i ndryshuar.
21. Ligji nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i përditësuar.

VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike”; Drejtoria e Përgjithshëm i Arkivave të Republikës së Shqipërisë.

Canada, Toronto Municipal Core, Chapter 27, Council Procedures.

Toronto; Reimagining Toronto’s Community Councils, Alexandra Flynn, 2017, University of Toronto (Scarborough); Journal of Law and Social Policy.

USA “Neighborhood Councils Rules, Standards and Best Practices”, City of Los Angeles, - California.

USA, “Neighborhood Council 2016 Election Manual”, Department of Neighborhood Empowerment and the Office of the City Clerk, City of Los Angeles - California.

USA, “Neighborhood Council - How to Handbook”, City of Missoula, Office of Neighborhoods.

USA, Neighborhood Council Training Manual, Legal Issues for Neighborhood Councils, Office of the City Attorney, City Attorney, City of Los Angeles 2006.

USA, Neighborhood Council Election Handbook - 2019, City of Los Angeles, California.

USA, The City of New York. Manhattan Community Board 3, bylaw and regulations.

City of Tacoma Neighborhood Council Program, Standards and Guidelines

USA, City of Los Angeles; Hollywood United Neighborhood Council Bylaws

Gjenevë, Bashkia e Vernier. Akti nënligjor i Këshillit Administrativ të Bashkisë të Vernier në lidhje me kontratat e lagjeve; 26 Nëntor 2013 (Geneve, Ville de Vernier, Règlement du Conseil administratif de la Ville de Vernier relatif aux Contrats de quartier, Du 26 novembre 2013).

Spanjë, Bashkia e Barcelonës, Udhëzues praktik për pjesëmarrjen e qytetarëve në Barcelona, Organet pjesëmarrëse, 2019; (Practical guides for citizen participation in Barcelona, Participatory bodies, 2019; Municipality of Barcelona).

Bashkia Tiranë, VKB nr. 14, datë 20.02.2017 “Për miratimin dhe zbatimin e programit “fondi i komuniteteve”

Bashkia Vlorë, Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e Strukturës Komunitare në Fshat.